

Republika e Kosovës



Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut



KOMUNA E JUAJ
PËR JU

VJETARI 2009
KORRIK - DHJETOR

Janar 2010

Boton:
Komuna e Kaçanikut

Përmbajtja:
Zyra e Informimit
www.komunakacanik.org

Retushimi profesional:
Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut

Shtypi:
Shtypshkronja "ERA" Ferizaj

Shpërndarja falas



Qytetarë të nderuar,

Në duar e keni vëllimin e dytë të Vjetarit 2009, ashtu siç iu kishim premtuar. Në këtë vëllim është përfshirë puna dhe aktivitetet e Komunës gjatë periudhës 1 korrik – 31 dhjetor.

Kompletimi i Vjetarit 2009 bëhet me qëllim të publikimit të punës, aktiviteteve dhe vendimeve të Komunës, ndërsa është edhe në funksion të rritjes së transparencës së Ekzekutivit dhe Legjislativit komunal në raport me Ju.

Edhe në këtë vëllim të Vjetarit 2009 në mënyrë kronologjike janë përfshirë vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë gjatë kësaj periudhe 6-mujore.

Vazhdojmë të mbetemi të hapur për vërejtjet dhe sugjerimet Tuaja.

Mbetemi prapa qëndrimit se bashkëpunimi i ndërsjellë na bënë më të suksesshëm.

*Me respekt,
Xhabir Zharku,
Kryetari i Komunës*

Korrik 2009

Kapërcehet për 21 për qind kuota e planifikuar vjetore nga tatimi në pronë

1 korrik – Komuna e Kaçanikut ka realizuar të hyra shumë të mira nga tatimi në pronë, sivjet, gjatë periudhës 1 janar - 30 qershor. Në fund të qershorit është kapërcyer kuota e planifikuar vjetore për arkëtim mjetesh nga ky lloj tatimi. “Më 30 qershor, shuma e projektuar me buxhetin e sivjetmë komunal për arkëtim mjetesh nga tatimi në pronë është kapërcyer për 21 për qind”, ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ndërkaq, zyrtarë të Zyrës së përhershme të tatimit në pronë kanë thënë se gjatë periudhës 1 janar – 30 qershor janë arkëtuar gjithsej 95.049 euro. “Janë arkëtuar 16.549 euro më shumë se kuota e planifikuar vjetore (78.500 euro)”, kanë saktësuar, zyrtarë të ZPTP-së.



Kryetari takon kreun e BSHL-së

6 korrik - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka pritur në një takim miqësor gjeneralin amerikan, z. Jones, komandant i Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes të KFOR-it, i cili shoqërohej edhe nga eprorë të lartë të Batalionit polako-ukrainas që operon në kuadër të kësaj brigade. Gjenerali Jones, pasi është falënderuar për pritjen miqësore, ka thënë se desha të njoftohem me arritjet e Komunës së Kaçanikut dhe potencialet për zhvillim të mëtutjeshëm. Kryetari Zharku, pasi u ka shprehur mirëseardhjen mysafirëve, ka thënë se arritjet tona janë të kënaqshme në të gjitha rrafshet. "Kemi bërë përparime sidomos në ndërtimin e infrastrukturës, por ne kemi nevojë dhe duhet bërë akoma më shumë", ka thënë z.Zharku. Kryetari i ka njoftuar mysafirët edhe me resurset e komunës për zhvillim.



Nëpunësve të gjendjes civile u zgjatet orari i punës

6 korrik – Është shtuar dukshëm numri i palëve kurbetçinj që aplikojnë për dokumente të gjendjes civile, ndërsa autoritetet komunale kanë marrë vendim për zgjatjen e orarit të punës nëpunësve përgjegjës për lëshimin e tyre. “Me vendim të kreut të Komunës, z.Xhabir Zharku, nga sot u është zgjatur orari i punës ofiqarëve dhe nëpunësve të zyrës pritëse”, ka thënë z.Fadil Guri, udhëheqës i personelit të administratës komunale të Kaçanikut. Ndërkaq, z.Murtez Mema, shef i Shërbimit të ofiqarisë, ka saktësuar se për 2 orë u është zgjatur orari i punës nëpunësve të sipërpërmendur. “Ofiqarët dhe nëpunësit e sporteleve në zyrën pritëse gjatë ditëve të punës do të punojnë nga ora 8:00 – 18:00, ndërsa të shtunave nga ora 9:00 – 16:00”, ka theksuar ai. Sipas kryeofiqarit Mema, me orar të zgjatur do të punojnë edhe ofiqarët e zyrave të vendit në terren. “Vendimi do të zbatohet derisa të konstatohet se nuk ka nevojë për të mbetur në fuqi”, ka thënë z.Mema.



Kryetari inspekton punimet për asfaltimin e rrugës në Bob

8 korrik - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka inspektuar punimet në fshatin Bob ku është duke u realizuar faza e dytë e projektit për asfaltimin e rrugës. Punimet janë në fazën përfundimtare, ndërsa sipas projektit është bërë shtrimi me asfalt i rrugës në gjatësi prej 450 metrash dhe gjerësi prej 5 metrash, pastaj është instaluar rrjeti i kanalizimit fekal në 120 metra gjatësi dhe janë shtruar 485 metra katrorë kubëza betoni. Vlera investuese e projektit është 49.863 euro. Kryetari Zharku nga afër e ka përcjellur asfaltimin e rrugës, ndërsa udhëheqës të komunitetit të fshatit janë shprehur të kënaqur me dinamikën e punimeve dhe cilësinë e punëve të kryera.



Testin e arritshmërsisë e kaluan 44 për qind e nxënësve kaçanikas

9 korrik - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës i ka publikuar rezultatet lidhur me kalueshmërinë e nxënësve në testin e arritshmërisë (semimaturës). Testit iu kanë nënshtruar gjithsej 812 nxënës, ndërsa rezultati i kalueshmërisë së tyre nuk kalon shifrën prej 44 për qind. Z.Avni Krasniqi, zyrtar i DAK-ut, ka shpjeguar se 58,8 për qind e semimaturantëve kanë arritur të tubojnë më tepër se 40 për qind të pikëve, 37,2 për qind më shumë se 50 për qind të pikëve, ndërsa vetëm 1.47 për qind kanë arritur më shumë se 80 pikë. Shikuar sipas shkollave, më e suksesshmja ishte ajo "Qamil Ilazi" e Kaçanikut të Vjetër me kalueshmëri 50.4 për qind, pastaj radhiten SHF "Nazmi Osmani" e Elezajve me 49, 9 për qind, SHF "Jusuf Gërvalla" e Biçecit me 46, 6 për qind, SHF "Emin Duraku" në qendrën komunale me 46,2 për qind etj. Rezultatit më të dobët të kalueshmërisë nga gjithsej 12 shkolla të këtushme e ka arritur SHF "Dituria" e Ivajës me vetëm 30, 3 për qind.

Nis pastrimi i shtratit të Neredimes

13 korrik - Ka nisur pastrimi i shtratit të lumit Neredime në rrjedhën e tij më se 1-kilometërshe përmes Kaçanikut. "Pastrimin e lumit janë duke e bërë 7 punëtorë dhe 1 tjetër me traktor", ka thënë z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Për realizmin e këtij projekti punëtorët e angazhuar ishin kontraktuar për 1 muaj. "Këta punëtorë do të marrin nga një pagë mujore në shumë prej 132 eurosh, ndërsa mjetet janë siguruar nga buxheti i drejtorisë që unë udhëheq", ka theksuar z.Ceka. Sipas tij, punëtorët janë përzgjedhur në bashkëpunim me Zyrën Komunale të Punësimit. "Punëtorët e kontraktuar nga komuna janë nga lista e punëkërkuesve me gjendje të

rëndë sociale", ka thënë Mehmet Mulaku, shef i ZKP-së në Kaçanik.



Kryetari takon zyrtarë të KOZ-së

15 korrik - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, është takuar me z. Albert Kinolli, anëtar i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KOZ), i cili shoqërohej edhe nga zyrtarë tjerë të lartë të këtij komisioni përgjegjës për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale, dhe nga Qemajl Hamdiu,



zyrtar ekzekutiv i KKZ-së në Kaçanik. Në takim u bisedua për kushtet dhe mënyrën e bashkëpunimit lidhur me zbatimin e procedurave zgjedhore të përcaktuara me ligj për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës. Kryetari Zharku u zotua se, sikurse edhe në të kaluarën, edhe tashti nuk do të mungojë përkrahja dhe ndihma e KKZ-së për KKZ-në. “Ne do t'i krijojmë kushte sa më të mira të mundshme për punë KKZ-së dhe hapësirë të mjaftueshme”, u ka thënë mysafirëve z.Zharku. Duke folur për rëndësinë e zgjedhjeve, kryetari Zharku ka thënë se këto zgjedhje janë të një rëndësie të veçantë pasi për herë të parë organizohen nga institucionet përgjegjëse të shtetit të Kosovës.

Kryetari takohet me përfaqësues të Lidhjes së Tretë të Prizrenit

17 korrik - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në zyrën e tij e ka pritur një delegacion të Lidhjes së Tretë të Prizrenit me seli në Nju Jork të SHBA-së. Delegacioni kryesohej nga zotërinjtë Ismet Berisha, kryetari i Lidhjes, Ismet Krasniqi, anëtar i kryesisë dhe Jetish Kadishani, përfaqësues i Lidhjes për Kosovë. Qëllimi i vizitës ishte zhvillimi i aktiviteteve të Lidhjes në Kosovë dhe në Komunën e Kaçanikut. Në takim është thënë se Lidhja e Tretë e Prizrenit synon të hap zyrën e saj në Kosovë dhe arkivin t'ia dhurojë Bibliotekës Kombëtare të Kosovës.



Është arkëtuar 80 për qind e shumës vjetore nga burimet e hyrjeve vetjake

17 korrik - Komuna e Kaçanikut i ka arkëtuar 207.115 euro nga burimet e të hyrave vetjake gjatë periudhës 1 janar-30 qershor. "Kjo shumë është ekuivalente me 80,2 për qind të kuotës së planifikuar vjetore për arkëtim nga të hyrat vetjake komunale (258.250 euro)", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Nga të hyrat direkte (tatimi në pronë dhe taksat komunale), ishin arkëtuar 196.840 euro, ndërsa nga ato indirekte (kryesisht gjobot në trafik), 10.991 euro. Më së shumti të hyra ishin realizuar nga tatimi në patundshmëri. "Nga ky lloj tatimi janë arkëtuar 94.341 euro", ka saktësuar z.Vërbani. Mjete të konsiderueshme ishin arkëtuar edhe nga taksa komunale administrative (19.551 euro) dhe ajo për regjistrim automjetesh (19.270 euro). "Arritjet në këtë rrafsh 'na kanë detyruar' të punojmë në hartimin e draftit të ri të buxhetit të sivjetmë komunal



me rritje prej më se 250 mijë eurosh", ka deklaruar drejtori Vërbani. Sipas tij, drafti i buxhetit të rishikuar do të jetë i gatshëm për shqyrtim dhe miratim në seancën e radhës të legjislativit komunal. Komuna e Kaçanikut edhe vjet ka regjistruar rezultate në arkëtim mjetesh nga burimet vetjake të të hyrave, ndërsa për këto arritje është shpërblyer nga USAID-i me një grant stimulues në shumë prej 45 mijë dollarësh amerikanë.

Është shpenzuar 40 për qind e buxhetit të sivjetmë

23 korrik - Komuna e Kaçanikut e ka shpenzuar 39,9 për qind të buxhetit të sivjetmë gjatë periudhës 1 janar - 30 qershor. "Në dispozicion ka qenë buxheti në shumë prej 4.013.972 eurosh, ndërsa gjatë kësaj periudhe janë shpenzuar 1.600.763 euro", ka saktësuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Sipas tij, për pagat dhe mëditjet e 773 të punësuarve në sektorin publik janë shpenzuar 1.224.155 euro ose 76,5 për qind e totalit të shumës së realizuar. Drejtori Vërbani ka thënë se për investime kapitale janë shpenzuar 13.1 për qind e mjeteve (209.399 euro), për mallra dhe shërbime 6,7% (107.532), për shërbimet komunale 1,9% (30.191) dhe për subvencione dhe transfere 1,8 për qind (29.486 euro). Me mjetet e fondit të investimeve kapitale sivjet ishte paraparë realizmi i 28 projekteve në shumë të projektuar prej 966.922 eurosh, ndërsa gjatë periudhës së sipërpërmendur ishin realizuar 8. "Katër projekte janë duke u realizuar ndërkohë, ndërsa 16 janë në procedurë tenderimi", ka thënë z.Vërbani.

Buxheti komunal bëhet më "i rëndë" për 254 mijë euro

26 korrik - Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit e ka hartuar versionin final të buxhetit të rishikuar komunal të vitit fiskal 2009 me rritje prej 254.250 eurosh, ndërsa hartues të këtij dokumenti kanë theksuar se 160 mijë euro të kësaj shume shtesë do t'u kthehen tatimpaguesve nëpërmjet investimeve në projekte me interes për ta. "Rritja e buxhetit është rezultat i arritjeve në arkëtim mjetesh nga burimet e hyrjeve vetjake gjatë periudhës 1 janar - 30 qershor", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i DFEZH-së. Ai ka rikujtuar se Komuna e Kaçanikut i ka arkëtuar 207.115 euro nga burimet e hyrjeve vetjake gjatë periudhës 1 janar-30 qershor ose 80,2 për qind të kuotës së planifikuar vjetore për arkëtim mjetesh nga këto burime (258.250 euro). Sipas tij, 160 mijë euro nga totali i mjeteve shtesë buxhetore do t'u kthehen tatimpaguesve nëpërmjet investimeve në projekte me interes për ta.



Nis realizimi i projektit për asfaltimin e rrugës në Çardak të Kaçanikut të Vjetër

28 korrik – Kanë nisur punimet për realizimin e projektit “Asfaltimi i rrugës në lagjen Çardak të Kaçanikut të Vjetër”. Projekti përfshin asfaltimin e rrugës në gjatësi 732 m dhe gjerësi 3 m. Asfalti do të ketë dy shtresa, 8 cm +3 cm trashësi dhe bankinat me zhavorr në të dyja anët e rrugës në gjerësi prej 1m. Vlera investuese e projektit është 50,491 euro. Mjetet janë siguruar nga buxheti komunal.



Legjislativi miraton buxhetin e rishikuar me rritje prej një çerek milioni euro

28 korrik - KK i Kaçanikut e ka miratuar me shumicë votash versionin final të buxhetit të rishikuar komunal të vitit fiskal 2009 me rritje prej 254.250 eurosh. "Rritja e buxhetit prej më se 1 çerek milioni euro është rezultat i arritjeve në arkëtim mjetesish nga burimet e hyrjeve vetjake gjatë periudhës 1 janar - 30 qershor", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ai ka thënë se gjatë periudhës së sipërpërmendur janë arkëtuar 207.115 euro nga burimet e hyrjeve vetjake ose 80,2 për qind të kuotës së planifikuar vjetore për arkëtim mjetesish nga këto burime (258.250 euro). Sipas tij, 160 mijë euro nga totali i mjeteve shtesë buxhetore do t'u kthehen tatimpaguesve nëpërmjet investimeve në projekte me interes për ta. Në agjendën e seancës ka qenë edhe Korniza afatmesme buxhetore 2010-2012, ndërsa ka kaluar edhe propozimvendimi i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shpalljen e zonës së lirë të gjuetisë. Me shumicë votash është miratuar edhe raporti 6-mujor i punës së Ekzekutivit komunal.



Komuna e Kaçanikut i ka 38 mijë e 170 banorë shqiptarë dhe 4 romë

30 korrik - Komuna e Kaçanikut i ka 38.174 banorë. Meshkuj janë 51,6 për qind, ndërsa femra 48,4. Pos 4 të anketuarve të cilët janë deklaruar romë, të gjithë të tjerët janë të përkatësisë etnike shqiptare. Kështu thuhet në raportin me të dhënat e përpunuara të regjistrimit joformal të popullatës së Komunës së Kaçanikut. Regjistrimin e ka bërë byroja projektuese "Data Gis Consulting" në bashkëpunim me KK-në. "Ky projekt është realizuar për nevojat e hartimit të Planit zhvillimor komunal (PZHK) dhe atij urban (PZHU)", ka theksuar përfaqësuesi i "Data...", z.Tomor Çela, menaxher i projektit. "Data Gis Consulting", me seli në Prishtinë, është kontraktuar nga KK-ja për hartimin e planeve zhvillimore komunale.



“Mirë se vini mërgimtarë!”

30 korrik - Në shenjë mirëseardhjeje e falënderimi për kontributin e pandërprerë atdhetar, me moton: “Mirë se vini mërgimtarë!”, Komuna e Kaçanikut, nën patronatin e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, ka organizuar aktivitete kulturore për kaçanikasit me qëndrim jashtë vendit. Në shtëpinë e kulturës “Xheladin Kurtaj” u dha shfaqja teatrale për fëmijë “Era, Bebushi dhe Xhemi Kaçadremi”, e realizuar nga Qendra për Zhvillimin e Teatrit për Fëmijë-Multimedia-Prishtinë, me regji të regjisorit kaçanikas Arben Apolloni. Ndërsa, në mbrëmje, në kalanë e qytetit, u dha një koncert ku morën pjesë Shoqata e Rapsodëve të Kosovës “Hivzi Sulejmani” nga Prishtina dhe dy SHKA nga Kaçaniku, “Shqiponja” dhe “Gryka e Kaçanikut”.



Gusht 2009

Projeksionet e Kornizës afatmesme buxhetore 2010-2012 të Komunës së Kaçanikut

1 gusht - Projeksionet e Kornizës afatmesme buxhetore (KAB) 2010-2012 të Komunës së Kaçanikut flasin për reduktim të fondit të pagave dhe mëditjeve gjatë 3 vjetëve të ardhshëm dhe shtim të atij të investimeve kapitale në raport me përqindjen e mjeteve për këto fonde të buxhetit të sivjetmë komunal. Buxheti i vitit fiskal 2009 e kishte paraparë shpenzimin e 70,7 për qind të mjeteve për paga dhe mëditje, ndërsa për 2010-ën ishte paraparë që ky fond "të gëlltisë" 58 për qind të buxhetit ose 12,7% më pak. Trend i lehtë zvogëlimi i këtij fondi ishte planifikuar edhe për vitin fiskal 2011 (56,3%) dhe 2012 (54,5%). "Ulja e përqindjes së këtij fondi është rezultat i shtimit në total të buxhetit komunal gjatë 3 vjetëve në vazhdim, ndërkohë që lartësia e pagave mbetet e pandryshuar bashkë me numrin e të punësuarve në sektorët publikë", ka theksuar z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ndërkaq, hartuesit e kësaj kornize kishin paraparë rritje të konsiderueshme të fondit të investimeve kapitale në raport me mjetet e alokuara për këtë fond të buxhetit të sivjetmë. "Fondi i investimeve kapitale më 2010 do të shpenzojë 30,2 për qind të buxhetit ose 17.3 për qind më shumë mjete në raport me shumën e sivjetme të këtij fondi buxhetor (13%)", thuhet në Kornizën afatmesme buxhetore 2010-2012. Shtim i lehtë i këtij fondi ishte projektuar edhe për dy vjetët vijues 2011 (32,8%) dhe 2012 (34,6%). "Shtimi i mjeteve të këtij fondi është rezultat i projeksioneve me rritje të granteve qeveritare dhe hyrjeve vetjake", ka theksuar drejtori Vërbani. Ai ka sqaruar se mjetet shtesë të buxhetit nga hyrjet e sipërpërmendura i shkojnë vetëm fondit të investimeve kapitale. Në KAB 2010-2012 ishte përfshirë edhe lista prej 35 projektesh kapitale të planifikuara për t'u realizuar me rreth 15,5 milionë euro mjete të buxhetit komunal dhe donacione të donatorëve qeveritarë dhe

joqeveritarë. Korniza afatmesme buxhetore 2010-2012 është miratuar nga Kuvendi komunal, ndërsa shportës së projekteve kapitale i janë shtuar edhe 5 sosh. Autorët e Kornizës..., buxhetin e viti fiskal 2010 e kishin projektuar në shumë prej 4.331.658 euro, ndërsa buxhetet 2 vjetëve vijues me ngritje të lehtë prej rreth 3,5 për qind.

Pushime gratis në Durrës për 20 persona me aftësi të kufizuara

2 gusht - Njëzet persona me aftësi të përhershme të kufizuara nga Kaçaniku dhe Hani i Elezit janë nisur për pushime 7-ditëshe në plazhet e Durrësit, të shtunën pasdite, bashkë me 7 persona të tjerë që do të përkujdesen për ta. Shkuarjen e tyre në pushime e ka mundësuar mbështetja financiare e KK Kaçanikut dhe e disa donatorëve të tjerë nga Hani i Elezit dhe Kaçaniku. "KK i Kaçanikut i ka lejuar 1.500 euro, ndërsa nga donatorë të tjerë janë siguruar edhe 1.600 euro", ka



theksuar z.Vedat Dema, koordinator i Njesisë për të drejtat e njeriut të KK të Kaçanikut. Sipas tij, përfituesit e pushimeve gratis janë raste të rënda në rrafshin shëndetësor dhe atë ekonomik, ndërsa përzgjedhja e tyre është bërë në bashkëpunim me zyrën e "Handikosit" në Kaçanik. Është pohuar se pushuesit nuk do të paguajnë as për fjetje. "Kryetari i Komunës, z.Xhabir Zharku, ua ka lënë në dispozicion për fjetje vilën e tij në Durrës", ka thënë Dema.

KKSB-ja e vlerëson të mirë gjendjen e sigurisë në Kaçanik

3 gusht - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi e ka vlerësuar të mirë gjendjen e sigurisë në Komunën e Kaçanikut. "Gjatë periudhës 1-muajshe ndërmjet dy takimesh nuk ka pasur incidente me efekt destabilizues për sigurinë e përgjithshme", ka theksuar togeri Jaser



Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor në Kaçanik. Ai ka nënvizuar se është rënduar gjendja në trafikun rrugor edhe për shkak të shtimit enorm të numrit të automjeteve në qarkullim pas ardhjes për pushime në vendlindje të kurbetçinjve. Nga diskutues të tjerë në takim janë dëgjuar edhe kritika në adresë të shoferëve për shkelje rregullash në trafik, ndërsa nga uniformat blu është kërkuar prani më e madhe me patrulla policore në rrugët e qytetit. Nga të pranishmit janë ngritur edhe disa çështje të tjera lidhur me sigurinë në komunitet, ndërsa me takimin ka udhëhequr z.Heset Loku, nënkryetar komune.

"Zhduken" 4 plehërishtat ilegale në qytet

7 gusht - "Janë zhdukur" 4 plehërishtat ilegale që patën lëshuar shtat në 2 rrugë të Kaçanikut. Punëtorë të NPRM "Pastërtia" janë parë duke i hequr hedhurinat nga plehërishtat në rrugën "Emin Duraku" në Kaçanik, ndërsa zyrtarë përgjegjës komunalë kanë theksuar se është arritur marrëveshja edhe për kthimin e kontejnerëve aty. "Me 'Pastërtinë' jemi marrë vesh për heqjen e mbeturinave nga 4 plehërishtat 'e egra' në rrugën kryesore 'Ismail Raka' dhe në atë 'Emin Duraku', sikundër edhe për kthimin e kontejnerëve", ka theksuar z.Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës. Ai ka pohuar se pushteti lokal i ka premtuar "Pastërtisë" se do të veprojë në drejtim të detyrimit të pronarëve të bizneseve me seli në rrugët e sipërpërmendura për kryerje obligimesh ndaj saj. "Do ta shikojmë edhe mundësinë e pezullimit të lejeve për ushtrim aktiviteti ekonomik në territorin e komunës për bizneset që refuzojnë t'i kryejnë obligimet ndaj kompanisë së mbeturinave", ka nënvizuar drejtori Ceka.

"Caritasi" i Luksemburgut dhe Komuna investojnë në Biçec

10 gusht - "Caritasi" i Luksemburgut është përcaktuar të investojë një shumë të konsiderueshme parash në Biçec të Kaçanikut, ndërsa zyrtarë vendës të kësaj organizate humanitare kanë theksuar se mjetet e alokuara para se gjithash janë në funksion të aktivizimit të komunitetit të fshatit për t'u përballur me sfidat zhvillimore. "Carluxi" më herët e ka lejuar një donacion prej 45 mijë eurosh për Biçecin, ndërsa në bashkëpunim me komunitetin e këtij fshati janë përzgjedhur 5 projektet në të cilat do të investohen mjetet e dhuruara. "Këshilli për Zhvillimin e Komunitetit (KZHK) është përcaktuar për 5 projektet të cilat do të realizohen edhe me participim të fshatarëve, ndërsa për fazën e parë të projektit për instalimin e rrjetit të kanalizimit fekal edhe Kuvendi Komunal i Kaçanikut i ka premtuar 40 mijë euro", ka theksuar z. Shabi Dullovi, kryeplak fshati. Se lista e projekteve të propozuara nga KZHK-ja e fshatit është miratuar, e kanë pohuar edhe zyrtarë vendës të "Caritasit" të Luksemburgut. "Projektet e miratuara u përkasin sektorëve: infrastrukturë, socioekonomik, rini e fëmijë dhe mjedis", ka theksuar z. Rifat Krasniqi, koordinatori i Programit për Zhvillimin e Komuniteteve (PZHK) të "Carluxit". Për rrjetin e kanalizimit fekal organizata e sipërpërmendur humanitare ishte pajtuar t'i investojë 20 mijë euro; për ndërtimin e fushës së sporteve në oborrin e SHF "Jusuf Gërvalla" të fshatit 10 mijë; për kursin e rrobaqepësisë dhe qëndisjes për gratë dhe vajzat 6.380; për riaktivizimin e SHKA "Rrezet e Sharrit" 3.620 dhe për ndërtimin e murit "të gjallë" rrethues të oborrit të shkollës së fshatit 5 mijë euro. Ndërkaq, koordinatori i KZHK-së, z. Kjani Sallahu, ka thënë se për realizimin e këtyre projekteve komunitetit i fshatit do të participojë me së paku 11 mijë euro mjete shtesë. Zyrtarë të "Carluxit" kanë rikujtuar se edhe për fshatin Kaçanik i Vjetër i kanë alokuar 45 mijë euro.

Kryetari vendos kurora lulesh te vendi i rënies së Agimit, Besnikut e Xheladinit

10 gusht - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tij, e kanë vizituar memorialin dhe kanë vendosur kurora lulesh pranë përmendores në fshatin Gabrricë ku para 11 vitesh ranë heroikisht dëshmorët: komandanti Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarët e tij, Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj. Kurora lulesh aty kanë vendosur edhe shumë bashkëluftëtarë të të rënëve dhe qytetarë. Më pas kryetari i Komunës dhe shoqëruesit e tij kanë vendosur kurora lulesh edhe te Varrezat e Dëshmorëve.



Buste për dëshmorin Ismail Raka dhe atdhetarin Sali Bajra, lapidar për viktimat civile

10 gusht - Me homazhe te Varrezat e Dëshmorëve dhe në vendin e rënies së dëshmorit Agim Bajrami, komandant i parë i Brigadës 162 të UÇK-së që ka operuar në rajonin e Kaçanikut, sikundër edhe me përfundim projektesh të realizuara infrastrukturore dhe program artistik të hënën është shënuar 10 Gushti, Dita e Dëshmorëve të Komunës së Kaçanikut. Janë përfunduar 5 projekte të realizuara dhe nisja e punimeve për realizimin e një tjetri. Aktivitetet në nderim të të rënëve në luftë për liri kanë nisur me zbulimin e bustit të veprimtarit politik dhe atdhetarit Sali Bajra, kryetar i KK të Kaçanikut në vitet e 60-a të shekullit të kaluar, i vendosur në oborrin e objektit të administratës komunale. Është zbuluar edhe busti i dëshmorit Ismail Raka dhe lapidari me emrat e gravuar të 126 viktimave civile të luftës. "Në kujtesën e popullit do të mbeten të gjithë ata që kanë punuar dhe luftuar për lirinë e tij", ka





theksuar z.Xhabir Zharku, kryetar komune. Ndërkaq, z.Xhelal Gashi, ish-shef i Drejtorisë Civile të Brigadës 162 "Agim Bajrami", ka nënvizuar se lufta e UÇK-së nuk do të rezultonte e suksesshme pa mbështetjen e



plotë nga popullata civile. Shiritat e kuq u janë prerë rrugëve të asfaltuara në fshatin Bob, në lagjen "Çardak" të Kaçanikut të Vjetër dhe në lagjen "Lekaj" të fshatit Doganaj. "Për realizmin e këtyre 5 projekteve janë investuar 177.283 euro të buxhetit komunal", ka thënë z. Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës. Aktivitetet shënuese janë përmbyllur me program artistik i mbajtur brenda mureve të kalasë mesjetare të qytetit.

Femrat luajnë futboll në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë

12 gusht - Në Ditën Ndërkombëtare të Rinisë, në organizim të Drejtorisë së Arsimit e Kulturës dhe Zyrës në Kaçanik të OSBE-së, është luajtur një ndeshje futboll në fushën e "Diti Sport" ndërmjet ekipeve të femrave nga Kaçaniku dhe Ferizaj. Në këtë përballje miqësore, fitore me rezultat 5:2 ka shënuar ekipi ferizajas. Shefja e Zyrës së OSBE –së në Kaçanik, znj. Julie Woloshin, ekipit futbollistik të femrave nga Kaçaniku i ka dhuruar 22 topa futboll, 20 palë çorapë sportive, 20 palë këpucë



sportive dhe 20 palë mbrojtëse për këmbë. I pranishëm në këtë aktivitet ka qenë edhe drejtori i DAK-ut, z. Azem Guri, i cili e ka falënderuar OSBE-në për ndihmën e dhënë ekipit kaçanikas, ndërsa e ka vlerësuar në funksion të inkurajimit të femrave për t'u marrë me aktivitete sportive.

Organizohet ekspozita e gjedhit “Kaçaniku 2009”

16 gusht – Qendra për Përkrahje të Bizneseve Lokale në Kaçanik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, në vendin e quajtur Meraja e Kolshit e ka organizuar ekspozitën e gjedhit „Kaçaniku 2009”. Ekspozitën e ka shpallë të hapur Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së, ndërsa fjala i është dhënë edhe kryetari të Komunës, z. Xhabir Zharku. “Ekspozitat si kjo janë të mirëseardhura, sepse nxisin fermerët që të merren me blegtori”, ka theksuar kryetari Zharku. Ndërkaq, Bajram Ymeri, drejtor i Departamentit të Blegtorisë në Ministrinë e Bujqësisë, ka thënë se ekspozitat e gjedhit janë ndër format më të mira të ekspozimit të vlerave marshuese të kafshëve.



Komisioni vlerësues vendin e parë në kategorinë e racës produktive ia kanë dhënë gjedhit të pronarit Naser Hasaj, vendin e dytë atij të Qazim Koxhës, kurse të tretin gjedhit të Vebi Zenunit. Gjedhi më i mire i racës autoktone "Busha" është zgjedhur ai i pronarit Osman Deda, të cilit i është dhënë vendi i parë dhe i dytë, ndërsa vendi i tretë i është dhënë gjedhit të pronarit Gani Koxha.

Jeton Topalli emërohet drejtor i Administratës së Përgjithshme

17 gusht – Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke u mbështetur në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale dhe në Statutin e Komunës së Kaçanikut, ka marrë vendim për emërimin e z. Jeton Topalli në postin e drejtorit të Administratës së Përgjithshme të KK-së. Jeton Topalli, i lindur më 4.7.1985 në Soponicë të Kaçanikut, është jurist me bachelor të mbaruar. Posti i kreut të DAP-it ka qenë e lirë pas dorëheqjes për arsye personale të drejtorit pararendës, Përparim Hajdari.



Nisin punimet për asfaltimin e rrugës në lagjet Fuga e Shorra të Biçecit

17 gusht – Kanë nisur punimet për realizmin e projektit “Asfaltimi i rrugës në lagjet Fuga e Shorra të fshatit Biçec”. Rruga do të shtrohet me asfalt në gjatësi prej 776 metrash dhe gjerësi prej 3 metrash. Në të dyja anët e rrugës do të ndërtohen edhe bankina në gjerësi prej 50 centimetrash. Asfalti do të jetë dyshtresor, 8 + 4 cm trashësi. Vlera e këtij projekti është 47.521 euro. Nga buxheti komunal janë alokuar 30 mijë euro, ndërsa komuniteti ka participuar me rreth 20 mijë euro.



MAPL-i dhe Komuna e bëjnë edhe me një kat objektin e administratës komunale

18 gusht – Kanë nisur punimet për ndërtimin e katit të tretë të objektit të administratës komunale. Në këtë kat do të jetë salla e mbledhjeve e legjislativit komunal, 10 zyra dhe hapësira tjera përcjellëse me sipërfaqe të përgjithshme prej 411,30 metrash katrorë. Projekti do të kushtojë 94.580 euro, ndërsa financohet nga MAPL-i dhe Komuna. MAPL-i ka dhuruar 90.000 euro, ndërsa mjetet tjera janë siguruar nga buxheti komunal. Shtimi i hapësirës në objektin e administratës komunale do të krijoj kushte më të mira pune sidomos për legjislativin komunal.



Komuna e Kaçanikut përfshihet në projektin LLOGOS

19 gusht - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pasur një takim pune me përfaqësues të Institutit për Hulumtime Zhvillimore Riinvest, që përfaqësohej nga zotërinjtë Hazir Gashi, menaxher i projektit për vlerësimin e aktiviteteve të LOGOS-it për periudhën 2010-2011, dhe Shaip Bytyqi. Tema të bashkëbisedimit kanë qenë realizimi i projektit për ngritjen e kapacitete njerëzore të Komunës dhe identifikimi i nevojave për investime kapitale në infrastrukturën e Komunës së Kaçanikut. Kryetari Zharku e ka mbështetur këtë projekt duke e vlerësuar si shumë të rëndësishëm. Ne kemi nevoja të shumta për investime në infrastrukturë, ka thënë z.Zharku, ndërsa nevojë të ngutshme e ka vlerësuar sigurimin e ujit të pijshëm për banorët e fshatit kufitar Gllloboçicë. Projekti LLOGOS (Shërbimet e qeverisjes lokale), zbatohet nga kompania zvicerane Inter Corporation, kurse financohet nga Qeveria zvicerane. Në takim është thënë se Qeveria zvicerane e ka miratuar buxhetin e këtij projekti për vitet 2010 – 2011 dhe është e interesuar që në kuadër të tij të përfshihen edhe Kaçaniku



e Hani Elezit. Projekti LLOGOS parasheh që paraprakisht të grumbullohen të dhëna nga Komuna në mënyrë që të bëhet një analizë për nevojat e Komunës së Kaçanikut. Nga këto të dhëna do të hartohet një raport me rekomandime që do të përmbajë edhe projektet të cilat kompania Inter Cooperation do t'ia propozoj Qeverisë zvicerane për financim.

Dëgjim publik për investimet kapitale 2010-2012

19 gusht - Në objektin e pallatit të kulturës „Xheladin Kurtaj“, Komuna e ka organizuar dëgjimin e parë publik me qytetarë për “Projeksionet dhe synimet zhvillimore – investimet kapitale 2010-2012”. Moderatorin e këtij dëgjimi, z.Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit dhe zyrtar kryesor financiar, njëherësh edhe përgjegjës kryesor për hartimin e draftbuxhetit, ka thënë se ky dëgjim ka për qëllim shpalosjen e objektivave të Ekzekutivit për periudhën 2010-2012, por edhe dëgjimin e komenteve dhe propozimeve të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në hartimin e buxhetit afatmesëm 2010-2012. “Për këtë periudhë i kemi paraparë 35 projekte infrastrukturore, ndërsa kësaj liste i janë shtuar edhe 5 pas takimeve të KPF-së dhe KK-së”, ka thënë z.Vërbani. Në dëgjim kanë marrë pjesë një

numër simbolik i qytetarëve, prandaj nga të pranishmit është vlerësuar se duhet ndërruar forma dhe vendi i mbajtjes. “Ndoshta do të ishte më mirë që këso debate të



organizohen në lokalitetet përkatëse ku do të nxiten qytetarët të marrin pjesë”, ka thënë z.Ramadush Osmani, administrator i fshatit Elezaj. Edhe Hajdin Bela nga Komiteti i Biznesit ka thënë se është më mirë që organet komunale t'i kontaktojnë qytetarët në lokalitetet e tyre. Enver Zharku, drejtor i kompanisë komunale të ujit dhe kanalizimit “Lypeteni”, ka propozuar që në listën e projekteve infrastrukturore të futet edhe ai për instalimin e rrjetit të ri të ujësjellësit dhe ndërtimin e rezervuarit të ri. Ndërkaq, qytetari Kjani Sallahu ka propozuar që në listë të përfshihet edhe projekti për mirëmbajtjen e monumenteve kulturore–historike të luftës së UÇK-së.

Nis asfaltimi i terrenit sportiv në oborrin e shkollës së Biçecit

21 gusht - Ka nisur shtrimi me asfalt i terrenit sportiv në oborrin e SHF “Jusuf Gërvalla” në Biçec. Terreni është me dimensione 25 me 40 metra, ndërsa vlera e projektit është 11.600 euro. Projektin e financojnë “Caritasi” i Luksemburgut me 9.900 euro, kurse pjesën tjetër Komuna dhe komuniteti i fshatit.



MTPT-ja, rreth 1.2 milionë euro për dy projekte në komunën tonë

25 gusht – MTPT-ja i ka lejuar 1.185.500 euro për dy projekte infrastrukturore në komunën tone. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe ministri i Ministrisë së Transportit dhe Postë-telekomunikacionit, z. Fatmir Limaj, në Prishtinë, i kanë nënshkruar dy marrëveshje për bashkëfinancim projektsh infrastrukturore në komunën tone. Marrëveshja e parë ka të bëjë me bashkëfinancimin e projektit “Asfaltimi i rrugës Kashan – Kotlinë në vlerë 1,050,000 euro”. Për realizmin e këtij projekti MTPT-ja do t'i alokoj 885.500 euro, kurse Komuna e Kaçanikut me 164.500 euro. Marrëveshja e dytë e nënshkruar ka të bëjë me bashkëfinancimin e projektit “Asfaltimi i rrugës në lagjen “Çardak”, krahu II., në fshatin Kaçanik i Vjetër”. Për këtë projekt MTPT-ja do t'i alokoj 300.000 euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut 30.000 euro.

Aksion pastrimi i ambientalistëve të rinj

28 gusht - Me iniciativë të Grupit të Ambientalistëve të Rinj është zhvilluar një aksion për pastrimin e hapësirës para qendrës së edukimit dhe arsimimit parafillor “Agimi” dhe oborrit të këtij institucioni arsimor.

Në këtë aksion kanë marrë pjesë 15 anëtarë të Grupit të Ambientalistëve të Rinj dhe disa anëtarë të Kryqit të Kuq komunal të Kaçanikut. Aksioni është mbikëqyrë nga z.Bujar Dullovi, inspektor mjedisor dhe Fatmir Çaka, koordinator i rinisë.



Bëhet prezantimi i fazës së parë të PZHK-së dhe PZHU-së

28 gusht - Kompania "Data Gis-Consulting" ka bërë prezantimin e fazës së parë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban, në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj". Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka thënë se ky është një projekt shumë i rëndësishëm për komunën tonë. "Hartimi i këtyre planeve përkon me interesat e zhvillimit të komunës sonë duke hapur shtigje për një zhvillim të gjithmbarshëm dhe të qëndrueshëm", ka nënvizuar kryetari Zharku. Prezantimin e profileve dhe gjendjes ekzistuese të planeve e ka bërë z. Tomor Çela, menaxher i projektit. Ai ka thënë se hartimit të profileve dhe gjendjes ekzistuese të planeve i ka paraprirë regjistrimi i popullsisë së Komunës së Kaçanikut.



Shtator 2009

Viti i ri shkollor fillon mbarë

1 shtator - Në të gjitha shkollat e komunës së Kaçanikut janë hapur dyert për nxënësit dhe personelin arsimor për fillimin e vitit të ri shkollor 2009-2010. Mësimi ka filluar në të gjitha shkollat e komunës tonë, dhe se çdo gjë është në rregull. Edhe inventari i cili ishte i pamjaftueshëm, është plotësuar, ndërsa edhe shtëpia botuese "Dukagjini" i ka shpërndarë tekstet mësimore për nxënësit e shkollave fillore. Në gjimnazin "Skënderbeu" si rezultat i kërkesave të mëdha për të gjetur ulëse në këtë shkollë dhe paraleleve të pamjaftueshme për ta absorbuar këtë fluks të nxënësve të klasave të dhjeta, është shtuar edhe një paralele e re e shkencave natyrore. Në këtë vit shkollor mësimin e vijnë 6.180 filloristë, 572 parafilloristë dhe 1.754 nxënës të shkollave të mesme, ndërsa klasat e para do të vijnë rreth 550 nxënës, ka theksuar z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës.

RIINVEST mbledh propozimet e kaçanikasve për nevojat e investimeve

4 shtator - Përfaqësues të Institutit për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST, janë takuar me përfaqësues komunalë, me ata të bizneseve dhe me administratorë të fshatrave, për t'i identifikuar kapacitetet dhe vlerësuar nevojat e investime në ngritjen e zhvillimit ekonomik dhe ndërtimin e infrastrukturës në përgjithësi gjatë periudhës dyvjeçare 2010-2011. Ky takim është mbajtur në vazhden e realizimit të draft-raportit të projektit LOGOS (Shërbimet e qeverisjes lokale), i cili parasheh që paraprakisht të grumbullohen të dhëna nga komuna në mënyrë që të bëhet një analizë për nevojat investive në komunën tonë, nevoja të cilat kompania zvicerane "Inter Corporation", implementuese e këtij projekti, do t'ia propozojë Qeverisë zvicerane për financim. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka përmendur me

këtë rast nevojën e decentralizimit të shërbimeve publike nga niveli rajonal në atë lokal dhe krijimin e infrastrukturës ligjore për shërbimet komunale. Ai e ka komentuar si diskriminim për qytetarët shkëputjen e dy ish-ndërmarrjeve publike “Bifurkacioni” dhe “Pastërtia” nga kompetencat komunale në ato rajonale



ALPO jep edhe 44 mijë euro për shkollën e Shtrazës

4 shtator - Shoqata italiane për lehtësimin e varfërisë (“Associazione Alleviare la Poverta”) ALPO, me seli në komunën Cagliari të Sardenias, ka dhuruar 44 mijë euro për ndërtimin e fazës së dytë të shkollës fillore 9-klasëshe të fshatit Shtrazë. në këtë projekt do të participojë edhe Komuna me 12.600 euro. Nëpërmjet këtij donacioni do të ndërtohet kulmi dhe meremetimi i shkollës, ndërsa inventarin do ta sigurojë MASHT-i. Faza e parë e projektit të kësaj shkolle është kryer më herët, ku shoqata ALPO ka investuar 73.800 euro, kurse Komuna ka participuar me 8.600 euro, ka theksuar drejtori i Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri.

Mbahet faza e dytë e testit të maturës

4 Shtator - Në afatin e muajit gusht 28 për qind e maturantëve të 2 shkollave të mesme të Kaçanikut e kanë kaluar provimin e maturës. Nga 349 maturantë sa i janë nënshtruar testit të maturës në afatin e dytë, kanë kaluar 97 syresh. Nga gjimnazi "Skënderbeu" kanë kaluar testin 31 për qind e maturantëve, kurse nga SHMP "Feriz Guri-Vëllezërit Çaka" 25.4 për qind e tyre, ka bërë të ditur z. Avni Krasniqi, zyrtar i arsimit.

Komuna ngrit monument kujtimi për "Kushtetutën e Kaçanikut"

7 shtator - "Në nderim të 7 Shtatorit 1990- Kushtetutës së Kaçanikut", është pllakë e cila kujton kohën e 19-vjetëve më parë, kur delegatët e



atëhershëm të Kuvendit të Kosovës i vunë bazën shtetësisë së vendit tonë. Ky monument kujtimi është zbuluar në sallën e vogël të Pallatit të Kulturës “Xheladin Kurtaj”, ambientin në të cilin delegatët e atëhershëm firmosën “Kushtetuta e Kaçanikut”. Pllakën e zbuluan z. Ilaz Ramajli, ish-nënkryetar i Parlamentit të atëhershëm të Kosovës dhe z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës tonë. Këtë pllakë e ka ngritur Komuna e Kaçanikut, ndërsa në ceremoninë e zbulimit kanë marrë pjesë ish-deputetë të legjislavit të atëhershëm dhe përfaqësues aktual të institucioneve lokale e qendrore.

Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku zbulimin e kësaj pllake e ka cilësuar si shenjë respekti e kujtimi për ata të cilët në kohë shumë të vështira morën guximin për ta shpallur Kushtetutën e Kosovës, si bazë dhe themel të fortë për lirinë dhe shtetësinë e vendit tonë. Ndërkaq, z. Ilaz Ramajli, ka vlerësuar se kjo pllakë na nderon neve anëtarëve të Qeverisë dhe të komisionit parlamentar të përbërjes së vitit 1990, por edhe qytetarët e Kaçanikut dhe udhëheqësit e tyre. Ministri në Qeverinë e Kosovës, z. Lutfi Zharku, ka vlerësuar se kjo pllakë sublimon gjithë dramacitetin dhe madhësinë e 7 Shtatorit, shënon ecjen tonë drejtë lirisë dhe ndërtimit të shtetit tonë”.

“Work-shop” për themelimin e komiteteve konsultative

7 shtator - Në organizim të Zyrës së OSBE-së dhe në bashkëpunim me përfaqësuesit e shoqërisë civile, është mbajtur punëtorja me temën: “Ngritja e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes dhe konsultimet publike me pjesëtarët e shoqërisë civile”, punëtori e cila është mbajtur në kuadër të projektit “Mbështetje pjesëmarrjes së publikut në jetën komunale publike përmes komiteteve konsultative”. Kjo punëtori kishte për fokus krijimin, rolin dhe funksionimin e komiteteve konsultative në komunën tonë. Është vlerësuar se pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse duhet ta iniciojë vetë shoqëria civile, e cila po ashtu duhet të bëjë projekte konkrete e serioze, ndërsa komitetet konsultative duhet të veprojnë konform udhëzimeve administrative. Përveç përfaqësuesve të institucioneve komunale, në këtë punëtori kanë marrë pjesë edhe ata të OJQ-ve, subjekteve politike në KK, administratorë të fshatrave etj.



Komuna ndan 10 mijë euro për stadiumin “Besnik Begunca”

8 shtator - Komuna ka ndarë 10 mijë euro për investime në stadiumin e futbollit “Besnik Begunca”, ndërsa projekti parasheh ndërtimin e një objekti të ri të zveshtores së futbollistëve. Memorandumin e bashkëpunimi për bashkëfinancim të projektit të renovimit të stadiumit të futbollit “Besnik Begunca” e ka nënshkruar kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe përfaqësuesi i KF Lepenci, z. Selajdin Zeneli. Mjetet për zveshtoren do të sigurohen nga fondi për bashkëfinancim të projekteve i programit buxhetor të Zyrës së kryetarit të Komunës, ka theksuar z. Hajrush Dullovi, zëdhënës i KK-së.



Ekspertët paraqesin vërejtjet për planet zhvillimore

8 shtator - Përfaqësues të qeverisë lokale dhe ata që përbëjnë grupet profesionale dhe të ekspertëve kanë adresuar disa vërejtje për pasaktësi në të dhënat e ofruara nga kompania prishtinase "Data Gis Consulting", e cila është kontraktuar për hartimin e Planit zhvillimor komunal dhe të atij urban të komunës tonë. Ndër vërejtjet është përmendur se nuk ka saktësi në të dhënat e regjistrimit të popullsisë dhe të gjendjes së varfërisë së skajshme, pastaj se në këtë plan është përfshirë edhe sipërfaqja tokësore e komunës së Hanit të Elezit, e që duhet të jetë vetëm për pjesën që i takon komunës tonë, etj. Këto dhe vërejtje të tjera u la që t'i përcillen me shkrim kompanisë "Data Gis Consulting", në mënyrë që t'i bëjë përmirësimet e duhura për prezantimin e profilit dhe gjendjes ekzistuese të Planit zhvillimor komunal dhe Planit zhvillimor urban.



Bursën e CARITAS-it të Luksemburgut e fitojnë 68 nxënës

9 shtator - Organizata CARITAS nga Luksemburgu ka publikuar listën me emrat e 68 nxënësve të klasave të dhjeta nga komuna jonë, të cilët kanë përfituar nga bursa e këtij fondacioni humanitar. Këto nxënës kanë përfituar nga 40 euro në muaj, ndërsa pagesa përfshin periudhën dhjetëmuajshe shtator 2009-qershor 2010. Vlera totale e saj ndihme është 27.200 euro. Për të përfituar nga kjo bursë kanë aplikuar gjithsej 200 nxënës. Përparësi për të marrë këtë ndihmë financiare kanë pasur nxënësit me rastet sociale, ata me aftësi të kufizuar, jetimët, nxënësit me prindër të papunësuar, ata nga viset rurale dhe nxënësit e gjinisë femërore, nxënësit me sukses dhe sjellje shembullore, si dhe ata familjet e të cilëve shkollojnë më shumë se tre fëmijë, ka theksuar z. Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës.



Kryeministri Thaçi merr pjesë në përrurimin e rrugës Kovaçec-Soponicë

13 shtator - Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi bashkë me kryetarin e Komunës, z. Xhabir Zharku si dhe babai i dëshmorit Feriz Guri, z. Faik Guri, kanë prerë shiritin e përrurimit të segmentit të rrugës Kovaçec-Soponicë, e gjatë 5.5 kilometra dhe e shtresuar me asfalt në gjerësi 6 metra. Kryeministri Thaçi është shprehur me këtë rast se ndihet mirë që po bën përrurimin e një rruge në trevën e Kaçanikut, siç e ka cilësuar ai, në trevën e njerëzve që kanë dhënë shumë për lirinë e vendit dhe kanë sakrifikuar gjithçka nga vetja për Kosovën. Kreu i Qeverisë ka thënë se edhe në të ardhmen nuk do të kursejë që të investohet për ta ndryshuar për të mirë Kaçanikun. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka falënderuar kreun e ekzekutivit për përkrahjen të cilën Qeveria ia ka dhënë komunës tonë. Asfaltimi i këtij segmenti rrugor është investim i MTPT-së e cila e ka financuar me 937



mijë euro, kurse Komuna ka participuar me 50 mijë euro. Rreth tre kilometra rrugë të cilat bashkë me këtë segment të përruar sot përbëjnë rreth 9 kilometra të projektit të tërësishëm të rrugës Bob-Doganaj, janë realizuar në tri faza të mëhershme gjatë periudhës 2005-2007.

Ndërtohet kanalizimi i ujërave të zeza në Biçec

14 shtator - Organizata CARITAS nga Luksemburgu dhe Komuna janë duke bashkë-financuar ndërtimin e kanalizimit të ujërave të zeza në fshatin Biçec. Kontrata e këtij projekti është nënshkruar në vlerën 63.995 euro, prej të cilave CARITAS ka dhuruar 20 mijë euro, kurse 43.995 euro i ka ndarë Komuna. Projekti do të realizohet në dy faza, ku në fazën e parë do të ndërtohen dy krahë të rrugës kryesore dhe pjesa më e madhe përgjatë rrugës kryesore, kurse në fazën e dytë parashihet të ndërtohet krahu i katërt i cili përbën vazhdimin e kanalizimit përgjatë rrugës kryesore e deri në dalje të këtij fshati. Në fazën e parë do të kryhen gjithsej 2.026 metra gjatësi të kanalizimit dhe do të ndërtohen edhe gropa septike në fund të rrjetit si dhe dy puseta filtruese, ka theksuar zëdhënësi i Komunës, z. Hajrush Dullovi.



Shënohet Dita e Rinisë në Kaçanik

19 shtator - Për nder të Ditës së Rinisë, përkatësisht manifestimit “Muaji i Rinisë” në komunën e Kaçanikut, sektori për Rini e Sport i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në bashkëpunim me MKRS-në, ka organizuar një manifestim kulturor-sportiv. Në emër të kryetarit të Komunës manifestimin e ka shpallur të hapur z. Azem Guri, drejtor i DAK-së. Ndërkaq, peticionin për liberalizimin e vizave me moton: “Edhe ne jemi Evropë”, përveç shumë të rinjve dhe qytetarëve, e ka nënshkruar edhe kryetari i Komunës, z Xhabir Zharku. Në rrjedhim të këtij përvjetori janë zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive, ndërsa janë shfaqur edhe pamje filmike me karakter edukativ dhe më pas është vazhduar me një rock koncert për të rinj.



Rreth 1.3 milionë euro për investime kapitale

30 shtator - Buxheti i përgjithshëm komunal për vitin 2010 është planifikuar të jetë 4.334.710 euro. Të hyrat e tërësishme të buxhetit do të sigurohen nga grantet qeveritare 3.375.547 euro dhe nga të hyrat vetjake në shumë 549.341 euro. Prej totalit të shumës buxhetore 3.070.369 euro janë paraparë të zbatohen për, siç është specifikuar, shpenzime rrjedhëse, ndërsa për shpenzime kapitale janë planifikuar 1.264.518 euro. Këto të dhëna janë në përmbajtjen e buxhetit komunal, i cili është miratuar në KK. Sipas z. Fikri Vërbanit, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, shuma më e madhe e buxhetit si zakonisht do të shpenzohet për paga, mëditje dhe kompensime të tjera (2.576.922 euro), pastaj për mallra e shërbime (371.770 euro), për shpenzime komunale (80.500 euro) dhe për subvencione dhe transfere (41 mijë euro). Ai ka bërë të ditur se për investime kapitale për vitin 2010 është planifikuar të investohen 1.264.518 euro. Janë gjithsej 25 projekte të cilat përbëjnë listën e investimeve kapitale për vitin 2010.



Tetor 2009

Kryetari inspekton punimet e kanalizimit në Biçec

2 Tetor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku i ka inspektuar punimet e fazës së parë të projektit të kanalizimit fekale në fshatin Biçec. Kryetari Zharku ka vlerësuar se ky është një projekt shumë i rëndësishëm dhe krijon edhe mundësi për zgjerimin e rrugës kryesore të këtij lokaliteti. Në këtë fazë është paraparë ndërtimi i tre krahëve të kanalizimit, ndërsa krahu i katërt në fazën e dytë. Këtë vit do të bëhen gjithsej 2.026 metra gjatësi të kanalizimit, ndërsa do të punohet edhe gropa septike në fund të rrjetit me $V=100\text{ m}^3$, si dhe dy puseta filtruese. Realizimi i këtij projekti kap vlerën 63.995 euro, prej të cilave 43.995 euro nga mjetet buxhetore të Komunës dhe 20 mijë euro donacion nga organizata CARITAS nga Luxemburgu.



Kryetari Zharku i dhuron makina qepëse grave të dëshmorëve

4 Tetor - Organizata CARITAS nga Luksemburgu ka ndarë 6.380 euro për një kurs të rrobaqepësisë në fshatin Biçec, të holla me të cilat janë blerë 16 makina për qepje dhe material tjetër përcjellës për aftësimin e femrave për këtë zana. Administratori i këtij fshati, z. Shabi Dullovi ka thënë se edhe Komuna e ka ndihmuar këtë kategori me 3.300 euro, për blerjen edhe të 15 makinave të tjera, gjë që ka ndikuar në shtimin e numrit të kursisteve të këtij lokaliteti. Për ta parë nga afër vajtjen e këtij kursi ka qëndruar për pak qaste edhe kreu komunal, z. Xhabir Zharku. Ai u ka dhuruar nga një makinë qepëse tri grave të dëshmorëve të këtij fshati, ndërsa ka premtuar se ndihmat për këtë kategori nuk do të mungojnë edhe në të ardhmen. Për rrjedhën e këtij kursi të cilin janë duke e vijuar 54 gra e vajza të këtij lokaliteti krytarin Zharku e ka njoftuar z. Kjani Sallahu, koordinator i Këshillit të Zhvillimit të Komunitetit të fshatit Biçec.



Koncert i madh me yje të estradës kosovare

5 Tetor - Kryeminsitri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, është paraqitur me një fjalë para të rinjve kaçanikas, gjatë një koncerti të të mbajtur brenda hapësirës së kalasë së qytetit. Kreu i Qeverisë e ka cilësuar rininë si perspektivë të vendit tone. Lideri numër një i ekzekutivit kosovar, z. Thaçi ka vlerësuar me këtë rast se Kosova dhe Kaçaniku po ndryshojnë për të mirë përditë e më tepër. Ai ka thënë se sot ka më shumë rrugë, më shumë shkolla, ujësjellës, kanalizime, hapësira të gjelbëruara dhe këto ndryshime të mira do të vazhdojnë të ndodhin edhe në të ardhmen. Në këtë koncert kanë performuar këngëtarët e mirënjohur: Kaltrina Selimi, Blero, Soni dhe ermal Fejzullahu.



Kryeministri i Kosovës takoi punëtorët shëndetësorë të Kaçanikut

6 Tetor - Kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, i cili shoqërohej edhe nga zëvendëskryeministri, z. Hajredin Kuçi, ka falënderuar punëtorët shëndetësorë të komunës tonë për punën e madhe që po bëjnë në vazhdimësi, ndërsa ka çmuar lart angazhimin e tyre sidomos gjatë periudhës së luftës. Kreu i ekzekutivit të vendit, z. Thaçi u ka bërë të ditur atyre se Qeveria ka marrë vendim për rritjen e pagave në lartësi 30 për qind të pagës ekzistuese të mantelbardhëve. Ndërkaq, z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, pasi i dëshiroi mirëseardhjen kryeministrit Thaçi, shprehu mendimin e tij se gjatë këtij mandate dyvjeçar është punuar mjaft shumë. Në vijim ai tha se po bëhen përpjekje për të riaktivizuar senatoriumin e dikurshëm, për të cilin e kam edhe mbështetjen e kryeministrit.



Nis asfaltimi i rrugës së “Çardakut” në Kaçanik të Vjetër

6 Tetor - Kanë filluar punimet për realizimin e projektit të asfaltimit të rrugës në lagjen “Çardak” të Kaçanikut të Vjetër. Kjo rrugë është e gjatë 2.817 metra dhe do të shtresohet me asfalt në gjerësi 5 metra dhe trashësi 12 centimetra. Rruga lidh lagjen “Çardak” dhe atë “Hoda” me rrugën magjistrale në Fushë të Pajtimit. Në kuadër të projektit do të punohet edhe muri me gurë në gjatësi 40 metra, i cili ndan Varrezat e Dëshmorëve me rrugën. Vlera investuese e projektit është 290.817 euro, prej të cilave 30 mijë euro i ka ndarë Komuna, ndërsa pjesën tjetër e mbulon Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomit.



Banka Botërore ndihmon me 18 mijë euro arsimin kaçanikas

6 Tetor - Banka Botërore i ka dhuruar Drejtorisë së Arsimit një donacion prej 18 mijë eurosh, të holla të cilat do të shpenzohen për krijimin e kushteve më të mira për vijimin e mësimit dhe avancimit të punës me pajisje teknike. Drejtori i Arsimit, z. Azem Guri ka theksuar se DAK-ja ka nënshkruar marrëveshje me MASHT-in, për zbatimin e projektit për zhvillim institucional të arsimit (IDEP), projekt i cili përmban fondin prej 11.136 eurosh për transportin e nxënësve të shkollave të mesme që vijnë nga viset e thella rurale, pastaj 3 mijë euro për pajisjen e bibliotekave të shkollave me tituj të ri, 1.800 euro për trajnimin e zyrtarëve financiarë të shkollave të komunës, 1.500 euro për projektin "Parandalimi i dukurive negative nëpër shkolla të mesme", 1.364 euro për pajisjen e DAK-së me pajisje teknike si dhe 1 mijë euro për gara të nxënësve të shkollave fillore. Drejtori Guri ka sqaruar se projekti do të zbatohet nga muaji tetor i këtij viti dhe do të zgjasë deri në qershor 2010.

Maturantët nisen në ekskursionin pesëditorë në Shqipëri

7 Tetor - 168 nxënës-maturantë të tetë paraleleve të gjimnazit "Skënderbeu" së bashku me profesorët e tyre, kanë udhëtuar në një ekskursion 5-ditorë në Durrës të Shqipërisë. Ata do të vizitojnë edhe Tiranën,



Krujën, Lezhën Beratit e Vlorën. Nënkryetari i Komunës, z. Hestet Loku dhe drejtori i arsimit, z. Azem Guri, kanë përshëndetur maturantët, duke u dëshiruar qëndrim të këndshëm, ndërsa i kanë këshilluar ata që të jenë të sjellshëm dhe shembull i ekskursioneve.

CARLUX ndihmon 68 nxënës me nga 400 euro

9 Tetor - Përfaqësues të organizatës CARITAS nga Luksemburgut kanë prezantuar në një konferencë shtypi implementimin e projektit për ndarjen e bursave për nxënës të klasave të dhjeta të shkollave të mesme të komunës tonë. Koordinatorja e sektorit të edukimit në këtë organizatë, znj. Valbona Rexhepi ka theksuar se bursat janë ndarë për 68 nxënës dhe përmbajnë nga gjithsej 400 euro për secilin nga përfituesit, për vijimin e shkollimit për 10 muaj të vitit shkollor. Përfituesit e bursave do të përzgjedhen në përputhje me kriteret e hartuara nga CARITAS. Në këtë konferencë shtypi ishte prezentë edhe znj. Christina Kaiser, kryesuese e Zyrës së CARITAS-it të Luksemburgut, zyrë e cila në Kosovë e ka selinë në Ferizaj.



KKSB-ja apelon te subjektet politike për fushatë të qetë

12 Tetor - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi ka mbajtur takimin e radhës, në të cilën është prezantuar gjendja e sigurisë në komunën tonë brenda periudhës gusht-shtator. U.d. i komandantit të Stacionit Policor, togeri Jaser Jaha dhe nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, gjendjen e sigurisë e kanë vlerësuar si të mirë. Njëri nga aksentet kryesore të takimit ishte përkushtimi për mbajtjen të qetë të situatës gjatë zgjedhjeve lokale të 15 nëntorit. Është vendosur që në emër të KKSB-së, shumica e përbërjes e të cilës vjen nga shoqëria civile, të apelohej publikisht në adresë të subjekteve politike pjesëmarrëse në zgjedhje, që të zhvillojnë fushatë të qetë dhe demokratike.



Në Kaçanik të Vjetër përurohen projektet e CARITAS-it

12 Tetor - Për nder të Ditës së shkollës "Qamil Ilazi" të Kaçanikut të Vjetër janë përuar projektet e realizuara nga Organizata CARITAS nga Luksemburgu. Në oborret e dy shkollave të këtij fshati janë përuar asfaltimi i dy fushave sportive si dhe dy kënde të lojërave për fëmijë. Shiritin e përuimit të projekteve të shkolla e re e kanë prerë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, z. Rifat Krasniqi- përfaqësues nga CARITAS-i dhe Jashar Selimi, banor i fshatit njëherit edhe invalid i luftës, ndërsa prerjen e shiritit të shkolla e vjetër e kanë bërë kryetari Zharku, z. Besim Ilazi- djali i dëshmorit Qamil Ilazi dhe përfaqësuesi nga CARITAS-i, z. Ilir Ukiqi. CARITAS-i Luksemburgut në fshatin Kaçanik të Vjetër ka financuar edhe projekte në sektorin e ambientit ku janë siguruar afër 300 kontejnerë si dhe 24 sera nga 75 metra katrorë. Për realizimin e këtyre projekteve CARITAS-i ka dhuruar 45 mijë euro, ndërsa Komuna ka participuar me 5 mijë euro.



Nxënës nga Gjermania vizitojnë Komplexin Memorial të dëshmorëve

13 tetor - Njëzetedy nxënës të klasave V – X të shkollës shqipe nga qytetet Dortmund, Arnsberg dhe Sunderni të Gjermanisë, të shoqëruar nga arsimtari Kemal Çallaku kanë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve të komunës tonë. Nxënësit bashkë me arsimtarin e tyre dhe prindërit, në shoqërim edhe të kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, kanë vendosur lule në kompleksin memorial. Kryetari Zharku u ka shpjeguar nxënësve për veprën heroike të dëshmorëve gjatë luftës së lavdishme të UÇK-së.



Program kulturor-artistik për nxënësit mërgimtarë

13 Tetor - Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" është shfaqur një program i përbashkët kulturor-artistik i nxënësve të shkollës fillore "Emin Duraku" të qytetit tonë dhe atyre të shkollës shqipe nga Gjermania. Në sallën e mbushur përplot nxënës, prindër e mysafir të tjerë, mirëseardhje nxënësve nga shkolla shqipe në Gjermani u ka dëshiruar kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Këta nxënës nga Gjermania janë duke qëndruar për një vizitë njëjavore në Kosovë, duke gjetur ngrohtësinë, mikpritjen dhe dashamirësinë e të afërmve dhe miqve të tyre.



Biçecasiit përurojnë projektet e CARITAS-it të Luksemburgut

14 Tetor - Në oborin e shkollës fillore "Jusuf Gërvalla" në fshatin Biçec, janë përruar pesë projekte të financuara nga CARITAS-i Luksemburgut. Shiritin e përrimit e kanë prerë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, administrator i fshatit, z. Shabi Dullovi dhe sekretari gjeneral i CARITAS-it, z. Phillip Street. Koordinatori i Këshillit të zhvillimit të komitetit të këtij fshati, z. Kjani Sallahu ka njoftuar me këtë rast se vlera e projekteve të përruara është 51.800 euro, prej të cilave CARITAS-i ka dhuruar 45 mijë euro, ndërsa Komuna 6.300 euro. Sipas z. Sallahu me këto mjete janë financuar: një pjesë e projektit të kanalizimit fekal, rrethoja e oborrit të shkollës, asfaltimi i terrenit sportiv të shkollës, kursi i rrobaqepësisë dhe riorganizimi i SHKA "Rrezet e Sharrit". Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka falënderuar këtë organizatë për ndihmën e dhënë dhe po ashtu ka falënderuar



edhe komunitetin e fshatit Biçec për angazhimin maksimal në realizimin e këtyre projekteve. Për realizimin e projekteve infrastrukturore të shkollës "Jusuf Gërvalla", ka falënderuar drejtori i saj z. Burim Bunjaku. Ndërkaq, sekretari gjeneral i CARITAS-it, z. Phillip Street ka premtuar se bashkëpunimi me Komunën dhe komunitetin e fshatit Biçec do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nis mbëltimi i 75 mijë fidaneve

19 Tetor - Në lokacionin "Ordenicë" të fshatit ka filluar pyllëzimi i një sipërfaqe të zhveshur rreth 30 hektarësh. Në këtë pjesë janë planifikuar të mbëltohen 75 mijë fidanë të llojit pishë e bardhë. Për realizimin e këtij projekti, i cili do të zgjasë 22 ditë, janë angazhuar 65 punëtor. Projekti është financuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në bashkëpunim me Agjencionin Pyjor të Kosovës si dhe Zyrën Komunale të Punësimin në komunën tonë.



Këshilltarët komunalë i japin fund mandatit dyvjeçar

19 Tetor - KK i Kaçanikut ka mbajtur mbledhje solemne, përshëndetëse me përbërjen e këshilltarëve të legjislativit lokal, të cilët u patën zgjedhur nga votat e qytetarëve në zgjedhjet e vitit 2007. Kryesuesi i KK-së, z. Xhelal Gashi i ka falënderuar këshilltarët e këtij mandati për kontributin e dhënë në punën e këtij institucioni. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, për angazhimin dhe kontributin e këshilltarëve i ka nderuar me nga një plaket gravurë. Kreu i Komunës poashtu ka ndarë të njëjta shpërblime edhe për kryesuesin e KK-së, nënkryetarin e Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale. KK i Kaçanikut gjatë këtij mandati dyvjeçar ka pasur gjithsej 31 anëtarë, prej tyre 17 nga radhët e PDK-së, 5 anëtarë nga LDK-ja, nga 3 sish të AAK-së dhe AKR-së, dy të tjerë nga LDD-ja, kurse Ora ka pasur një këshilltar.



Meremetohen dhe asfaltohen disa rrugë lokale, vlera 63 mijë euro

20 Tetor - Me mjete të buxhetit komunal të Kaçanikut kanë filluar të realizohen një sërë projektesh të meremetimit dhe asfaltimit të disa rrugëve lokale të komunës tonë. Është duke u realizuar projekti për meremetimin e rrugës në lagjen "Kuçishtë" të Begracës (4.500 euro), meremetimi i rrugës nga lagjja Topalli deri në Sepetin të Dubravës (7.500 euro), asfaltimi i rrugës hyrëse në qytet nga rruga magjistrale (18.100 euro), shtruarja me kubëza betoni e rrugës së lagjes "Luma" në Gllobiçicë (20 mijë euro), faza e dytë e shtruarjes me kubëza e rrugës "Ramadan Agushi" në qytet (9 mijë euro), shtruarja e rrugës me zhavorr në fshatin Gjurgjedell (3 mijë euro) si dhe rrugët e lagjeve Lamaj e Tifeku". Projektet e meremetimit dhe asfaltimit të këtyre rrugëve kapin shumën totale 63.091 euro të buxhetit komunal.



Shqyrtohet drafti parafinal i PZHK-PZHU-së

29 Tetor - Në sallën e mbledhjeve të KPF-së, është shqyrtuar drafti parafinal i tri fazave të prezantuara deri më tani të Planit zhvillimor komunal dhe Planit zhvillimor urban të komunës tonë. Grupi punues komunal, Këshilli i ekspertëve, kompania "Data Gis Consulting" dhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kanë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet rreth tri fazave të prezantuara deri më tani: Fazës së parë "Profili dhe gjendja ekzistuese e PZhK-së dhe PzHU-së, fazës së dytë "Vizioni, parimet dhe caqet", si dhe fazës së tretë "Korniza e zhvillimit hapësinor urban". Drafti i PZHK-PZHU-së do të jetë në diskutim publik për dy muaj dhe më pas drafti final do të miratohet nga legjislativi lokal.



Inaugurohet rruga e re hyrëse për në qyteti

30 Tetor - Në daljen nga magjistranja e cila vjen nga drejtimi i Ferizajt, është përruar rruga e re hyrëse për në qytet, hyrje e cila tash përshkon një më linjë të drejtë, duke iu shmangur dy lavesave të deritanishme 90 shkallëshe. Shiritin e përrimit e kanë prerë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe drejtori i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, z. Misim Sopa. Kjo rrugë është financuar nga mjetet e buxhetit komunalë dhe ka kushtuar 18.091 euro. Punët në asfaltimin e sipërfaqes prej 641.68 metra katrorë i ka kryer kompania NNT "Eurotrans" nga fshati Doganaj.



Nëntor 2009

Kryetari Zharku takohet me auditorët e “Deloitte Kosova”

2 nëntor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe drejtori i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, z. Fikri Vërbani, kanë takuar z. Amir Dërmala, mbikëqyrës në kompaninë “Deloitte Kosova” nga Prishtina, ekip i cili është duke bërë auditimin në komunën tonë për vitin 2008. Këtë kompani e ka angazhuar Zyra e auditorit të përgjithshëm në nivel qendror. Z. Dërmala ka thënë se puna në terren e auditimit në Administratën komunale do të kryhet brenda një jave, ndërsa draft raporti i auditimit për vitin 2008 do të jetë i gatshëm në fillim të muajit dhjetor 2009, përderisa drafti final do të jetë i gatshëm në fund të muajit dhjetor 2009



Rehabilitohet tatëpjeta në “Bazhdarhanë” afër Semajës

6 Nëntor - Ka filluar të rehabilitohet tatëpjeta e madhe në rrugën hyrëse të fshatit Semajë. Shqetësimi ishte ngritur ditë më parë nga banorët e fshatit Semajë, se në lokacionin “Bazhdarhan”, në rrugën hyrëse të fshatit, ishte krijuar tatëpjetë e madhe gjatë ekzekutimit të punëve në asfaltimin e rrugës Ferizaj-“Bazhdarhanë”. Rehabilitimin e tatëpjetës është duke e bërë kompania “Eskavatori”, e cila është duke implementuar projektin për asfaltimin e rrugës Ferizaj-“Bazhdarhanë”, që lidh Ferizajn në anën veri-perëndimore me komunën tonë, si dhe me komunën e Shtërpçës.

Komuna i merr kompetencat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve buxhetore

11 nëntor - Në përputhje me Udhëzimin administrativ 02/2009, për delegimin e menaxhimit të shpenzimeve tek organizatat buxhetore komunale, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave i ka deleguar kompetencat e menaxhimit financiar nga



niveli qendror në komunën tonë. Delegimi i kësaj kompetence ka mundësuar që ekzekutimi i pagesave të shpenzimeve të bëhen drejtpërdrejt në komunë, ndryshe nga deri tani që këto pagesa janë ekzekutuar nga Zyra e Thesarit regional në Gjilan. Regjistrimi i shpenzimeve të para ka filluar më 9 nëntor 2009, ndërsa procesi po ecën mirë. Në prani të përfaqësuesve finaciare vendorë e ndërkombëtarë të nivelit qendror të qeverisjes, në një takim zyrtar në Kaçanik, nënkryetari i Komunës, z. Hestet Loku, në emër të kryetarit Zharku i ka nënshkruar certifikatat për autorizimin e zbatimit të kompetencave të marra, dhe të njëjtat ua ka dorëzuar zyrtarëve të certifikuar në fushat përkatëse: z. Ibrahim Gjini, zyrtar certifikues – aprovues, z. Shefket Koxha, zyrtar për regjistrimin e shpenzimeve dhe z. Hasan Kriva, zyrtar për pranimin e mallrave edhe shërbimeve.

Nis realizimi i segmentit të dytë të rrugës së tri lagjeve të Biçecit

13 nëntor - Kanë filluar punimet në asfaltimin fazës së dytë të rrugës në lagjet Fuga-Shorra-Zharku. Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku e ka vizituar këtë vendpunishte dhe është takuar me banorët e lagjeve të sipërpërmendura dhe punëtorët e kompanisë e cila është duke i kryer

punimet. Faza e dytë e asfaltimit të kësaj rruge është e gjatë 938 metra, ndërsa do të asfaltohet në gjerësi 3 metra dhe trashësi 8 centimetra. Do të rregullohen edhe bankinat me



zhavorr në të dy anët e rrugës. Asfaltimi i këtij segmenti është kontraktuar për 49.322 euro të buxhetit komunal. Punët është duke kryer kompania "Eurotrans" nga fshati Doganaj.

Shënohet rasti i parë i infektimit me gripin derrave

18 nëntor - Në komunën tonë është shënuar rasti i parë i virusit AH1N1, ndërsa personi i infektuar ka ardhur nga Zvicra dhe është femër e moshës së re, është thënë në takimin e përfaqësuesve të Institutit Rajonal të Shëndetësisë Publike në Ferizaj me drejtues të institucioneve arsimore e shëndetësore të komunës tonë. Duke shpjeguar për situatën pandemike në rajonin e Ferizajt, për rastin e sipërpërmendur ka njoftuar epidemiologu Sylejman Topalli, drejtor i Institutit Rajonal të Shëndetësisë Publike në Ferizaj, i cili ka pohuar se megjithatë gjendja shëndetësore e të infektuarit është e mirë. Z. Topalli ka thënë që të mos lëshohen dezinformata dhe panik, sepse nuk është gjendja për alarm, ndërsa si masë parandaluese ka këshilluar drejtorët e shkollave të komunës për regjim të higjienës nëpër shkolla.



Komuna jonë bëhet me Qendër për regjistrimin e automjeteve

23 nëntor - Në një ceremoni solemne është hapur Qendra e regjistrimit të, ndërsa këto shërbime do të kryhen në objektin barakë, të cilën Komuna e ka vënë në dispozicion deri në ndërtimin e një objekti të ri. Shiritin e përrurimit të kësaj qendre e kanë prerë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z. Besnik Berisha, drejtor i Departamentit për Regjistrimin e Automjeteve (MPB). Kryetari Zharku ka thënë se në këtë qendër do të kryhen të gjitha shërbimet për regjistrimin e automjeteve, ndërsa në të ardhmen parashihet edhe lëshimi i dokumentit të patentë-shoferëve. Nëpërmjet konkursit të MPB-së koordinator i kësaj qendre është zgjedhur z. Nusret Dullovi.



Sensibilizim kundër dhunës në “Ditën e kordeles së Bardhë”

25 nëntor - Në Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas, siç quhet ndryshe “Ditës së kordeles së Bardhë”, organizuar nga Zyra për Barazi Gjinore dhe të Drejtave të Njeriut, është mbajtur një takim sensibilizues për eliminimin e dhunës ndaj grave. Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku ka vlerësuar me këtë rast është i nevojshëm angazhimi i përbashkët për luftimin e kësaj dukurie negative në shoqërinë tonë. Rastet e dhunës duhet denoncuar dhe trajtuar me prioritet organet kompetente, ka thënë kryetari Zharku, i cili duke folur për rolin e gruas në shoqërinë tonë në përgjithësi, tha se ajo duhet të jetë shumë më aktive dhe vetëiniciuese në kërkim të të drejtave të veta. Zyra për Barazi Gjinore dhe të Drejta të Njeriut ka nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Policinë e Kosovës, Gjykatën Komunale, Qendrën e Punës Sociale, Drejtorinë e Arsimit, Bashkësinë Islame, Klubin e Gazetarëve dhe SHG “Lidhja e Gjallë e Kosovës”, për bashkëpunim dhe koordinim të punëve për luftimin e dhunës në baza gjinore.



Urime festën e Kurban Bajramit

24 nëntor - Qytetarë të nderuar,

Me rastin e festës së Kurban Bajramit, kam kënaqësinë e veçantë që bashkë me ju të ndaj gëzimin dhe dashurinë që sjell për ne kjo festë e madhërishme me dëshirë që të ju sjell shëndet, paqe e lumturi e para së gjithash solidaritet vëllazëror.

Edhe me këtë rast me pietet kujtojmë të gjithë ata që u sakrifkuan për lirinë e Kosovës, të gjithë dëshmorët, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre, që ne të festojmë sot të lirë.

Në veçanti uroj dhe përgëzoj familjet e dëshmorëve, që edhe në këtë ditë feste, të ndihen krenar për gjakun e derdhur të më të dashurve të tyre, që solli pavarësinë e Kosovës.

Me shumë respekt,
Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku

Urime Festat e Nëntorit

27 nëntor - Kam kënaqësinë që në emër të institucioneve komunale, të gjithë qytetarëve të komunës tonë t'ua uroj 28 Nëntorin - Ditën e Flamurit Kombëtar, ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari dhe paraqitjen publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ky është përvjetori i dytë që Festat e Nëntorit po i kremtojmë në Kosovën e pavarur, ideal për të cilin shqiptarët luftuan nëpër breza, ndërsa u finalizua me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Qytetarë të nderuar,

Ju urojmë përzemërsisht shëndet, mirëqenie, paqe dhe harmoni.

Me respekt,
Kryetari i Komunës
z. Xhabir Zharku

Kremtohen Festat e Nëntorit

27 Nëntor - Organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe në përkujdesen e kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zharku, për nderë të festave të nëntorit: 28 Nëntorit- Ditës së Flamurit, përvjetorit të daljes në skenë të UÇK-së, ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe 15 vjetorit të rënies së dëshmorit Ismail Raka, në Pallatin e Kulturës "Xheladin Kurtaj" është mbajtur një manifestim kulturor. Fjalën e rastit e ka mbajtur z. Ejup Runjeva, kryetari i OVL-së në komunën tonë. Në emër të kryetarit të Komunës ka përshëndetur dhe ka uruar për festat nënkryetari Komunës, z. Hestet Loku. Për nder të kësaj dite të veçantë për kombin tonë, është shfaqur edhe një program kulturor-artistik.



Dhjetor 2009

KOZ-ja certifikon rezultatet e zgjedhjeve për anëtarë të KK-së

2 dhjetor - Sipas rezultateve përfundimtare për këshilltarë komunalë, të certifikuar nga KOZ-ja, në legjislativin komunal përfaqësim kanë siguruar PDK-ja, AAK-ja, LDK-ja, AKR-ja dhe LDD-ja. PDK-ja i ka fituar 47.5 për qind të votave, AAK-ja 25.5 %, LDK-ja 16.5 %, AKR-ja 7.9 % dhe LDD-ja 2.5 %. KOZ-ja i ka certifikuar edhe emrat e kandidatëve të partive të sipërpërmendura cilët kanë siguruar vende në KK-së për mandatin 2009-2013. PDK-ja do t'i ketë 13 këshilltarë, AAK-ja 7, LDK-ja 4, AKR-ja 2 dhe LDD-ja 1. Këshilltarë nga radhët e PDK-së janë zgjedhur: Xhelal Gashi, Ilaz Ceka, Tefik Vishi, Heset Loku, Afrim Bunjaku, Kemajl Murseli, Driton Thaçi, Krenare Luzha, Zekirja Loku, Habib Guri, Florije Dalloshi, Arbnora Sallahu dhe Diana Bajrami; nga AAK-ja: Shyqeri Luzha, Shukri Luta, Hajdar Loku, Rami Çaka, Sevdije Frangu, Nerimane Lika dhe Afërdita Deda; nga LDK-ja: Daut Rudi, Ibrahim Hoxha, Nazife Krasniqi dhe Florijeta Gashi; nga AKR-ja: Ali Krasniqi dhe Sherife Troni, ndërsa nga LDD-ja Elife Murseli.

Nisin punimet për asfaltimin e rrugës së Kotlinës

11 dhjetor - Kanë nisur punimet për asfaltimin e rrugës që e lidhë fshatin Kotlinë me magjistralen Prishtinë-Shkup, ndërsa projekti është duke u realizuar me mjete të Ministrisë së Transportit dhe Postë-telekomunikacionit dhe të buxhetit komunal. "Për këtë projekt MTPT-ja i ka alokuar 682.463 euro, ndërsa nga buxheti komunal janë siguruar 164.500 euro", ka thënë z.Hajrush Dullovi, zëdhënës i KK-së. Ndërkaq, z.Bekim Troni, drejtor i Urbanizmit, ka sqaruar se afaltimi i rrugës do të



bëhet në gjatësi prej 7,5 kilometrash. "Asfaltimi i rrugës do të bëhet në gjerësi prej 4 metrash dhe trashësi prej 8 centimetrash", ka thënë drejtori Troni.

Skanohen dhe digjitalizohen dokumentet e kadastrit

17 dhjetor - Në administratën komunale ka nisur skanimi dhe digjitalizimi i dokumenteve të arkivuara të kadastrit. Do të skanohen dhe digjitalizohen jo vetëm fletët poseduese dhe kadastrit përshkruar, por edhe i tërë dokumentacioni tjetër i arkivuar që nga themelimi i kadastrit e deri tashti.. Z.Vebi Koraçi, koordinatori i Kadastrit, ka thënë

se në vazhdim të digjitalizimit të shënimeve arkivore është duke u bërë edhe digjitalizimi i fotoskicave të aeroinçizimeve të bëra në vitet 1958 dhe 1970. Këtë projekt është duke e financuar Banka Botërore.



GTZ-ja ia dorëzon drejtorit të DAK-ut materialin nga vizita në Gjermani

18 dhjetor- Zyrtarë të GTZ-së ia kanë dorëzuar drejtorit të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, z.Azem Guri, materialin nga vizita studimore në Gjermani. Drejtori Guri materialin e ka pranuar nga dr. Horst Steel, menaxher i projektit “Arsimi fillor” të GTZ-së në Prishtinë, i cili shoqërohej znj. Lena Stamm, këshilltare e projektit të sipërpërmendur dhe znj.Bukurije Kameri, koordinatorë e projektit. Një delegacion i MASHT-it, në bashkëpunim me GTZ-në gjermane, kanë qenë në vizitë studimore në Gjermani, sivjet, gjatë periudhës 28 nëntor-5 dhjetor. Në këtë delegacion ka qenë edhe z.Azem Guri, në cilësinë e anëtarit të Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve. Delegacioni gjatë vizitës është njoftuar me modalitetet e sistemit arsimor në Gjermani. Dr. Steel e ka njoftuar drejtorin Guri se GTZ-ja për periudhën 2010-



2012 do ta bëjë trajnimin e mësimdhënësve të shkencave natyrore dhe drejtorët e shkollave të 3 komunave të Kosovës. Në këtë projekt trajnues është përfshirë edhe Komuna e Kaçanikut. Zyrtarët e GTZ-së, të shoqëruar nga z. Guri, e kanë vizituar SHF "Ali Asllani" në Doganaj.

Sovrani ia beson edhe një mandat qeverisës kryetarit Zharku

24 dhjetor – Sovrani ia ka besuar edhe një mandat qeverisës kryetarit aktual të Komunës së Kaçanikut, z.Xhabir Zharku. Sipas rezultateve përfundimtare të balotazhit të 13 dhjetorit, të certifikuara nga KOZ-ja, për z.Xhabir Zharku (PDK) kanë votuar 7.633 votues ose 58,21%, ndërsa për rivalin e tij z.Tahir Çaka (AAK) 5.479 votues ose 41,79%. Në raundin e parë të zgjedhjeve, i mbajtur më 15 nëntor, në garë për postin e kryetarit të Komunës së Kaçanikut kanë qenë edhe 3 kandidatë tjerë. Në këtë raund për z.Xhabir Zharku kanë votuar 48,4% e votuesve, për z.Tahir Çaka 26,6%, për z.Lulzim Dema (LDK) 15,9%, për z.Afrim Loku (AKR-LDD) 9% dhe për kandidatin e pavarur Naim Mustafa 0,1%.



Kryetari vlerëson angazhimin e drejtuesve të dikastereve komunale

28 dhjetor - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka zhvilluar një takim me drejtorët e drejtorive komunale, të cilët i ka falënderuar për angazhimin dhe punën e tyre për vitin që po e lëmë pas.

Kryetari Zharku ka vlerësuar pozitivisht punën e tyre në përgjithësi gjatë vitit 2009, si rezultat i të cilëve ka pasur suksese të shumta. Jam i kënaqur me punën dhe rezultatet e arritura, por gjatë vitit të ardhshëm duhet të vazhdohet me punë dhe përkushtim edhe më të madh, i ka porositur drejtorët kryetari Zharku.

Punën e drejtuesve të dikastereve komunale e ka vlerësuar edhe nënkryetari i komunës, z. Hestet Loku.

Edhe drejtorët e drejtorive janë shprehur të kënaqur me suksesin e arritur dhe bashkëpunimin e mirë, ndërsa janë zotuar se nuk do të mungojë angazhimi i tyre edhe në të ardhmen.



Hapja e QRA-së, efekt pozitiv për shërbime të qytetarëve

28 dhjetor - Qendra e regjistrimit të automjeteve, e cila, si rezultat i angazhimit të kryetarit të Komunës, z. Xhabir Zhakru, është hapur më 16 nëntor 2009, është duke u frekuentuar jashtëzakonisht shumë nga palët, për rregullimin e dokumenteve të automjeteve të tyre. Për 27 ditë të punës në QRA kanë aplikuar për shërbime të automjeteve 540 palë. Prej tyre 319 kanë qenë kërkesa për vazhdimin e regjistrimit të automjeteve dhe 53 sish për regjistrim të ri të tyre, ka theksuar z. Ibrahim Kuqi, zyrtar i bazës në këtë qendër. Se sa e nevojshme ka qenë hapja e kësaj qendre, tregojnë statistikat e lëndëve të cilat pritet ta vizitojnë këtë qendër brenda viteve të ardhshme. Sipas koordinatorit të kësaj qendre, z. Nusret Dullovi, janë rreth 7.400 lëndë aktive për rregullimin e dokumentacioneve të automjeteve, shumica e të cilëve janë për vazhdimin e regjistrimit të automjeteve.

Tenderë prej më se 1 milion euro janë realizuar nga Zyra e Prokurimit më 2009

29 dhjetor – Zyra e Prokurimit i ka shpallur gjithsej 58 tenderë vlerash të mëdha, të mesme dhe të vogla gjatë vitit 2009, ndërsa 14 janë anuluar. “Dyzet e katër tenderë janë shpërblyer me kontrata në vlerë



totale prej rreth 1 milion eurosh”, ka thënë z. Zeqir Selmani, menaxher i ZP-së. Gjatë vitit që e lamë pas janë shpallur edhe 101 tenderë vlerash minimale në shumë totale prej 41.178 eurosh.

Kryetari e vlerëson profesionale punën e gazetarëve kaçanikas

29 dhjetor – Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në pritjen e fundvitit për gazetarët kaçanikas e ka vlerësuar profesionale punën e tyre gjatë vitit 2009. Raportet tuaja gazetareske kanë qenë reale dhe korrekte edhe atëherë kur ato kanë pasur tone kritike për punën e pushtetit lokal, u ka thënë gazetarëve z. Zharku. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve: Daut Shehu (Infopress), Ekrem Raka (KOHA Ditore), Kjani Sallahu (Zëri) dhe Ekrem Dullovi (Radio Kaçaniku), kryetari Zharku e ka vlerësuar të suksesshme punën dhe aktivitetet e pushtetit komunal në të gjitha rrafshet në vitin që e lamë pas. Gjatë vitit 2009 janë realizuar 54 projekte infrastrukturore, ndërsa 4 syresh kanë mbetur për t'u përmbyllur në vitin 2010, ka theksuar kryetari Zharku. Ndërkaq, z. Fikri



Vërbani, drejtor i financave, pjesëmarrës në këtë konferencë, ka sqaruar se vlera e investimeve kapitale gjatë vitit që e lamë pas ishte 2.406.473 euro, prej të cilave 1.033.126 euro ishin mjete të buxhetit komunal, ndërsa 1.373.347 euro nga grantet qeveritare dhe donacionet. Kryetari Zharku ka shtuar ndërkaq se vlera e 4 projekteve në realizim e sipër është 1.440.436 euro, prej të cilave 1.397.520 euro janë donacion nga Qeveria e Kosovës dhe 42.915 euro nga buxheti komunal. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në këtë konferencë është shprehur relativisht i kënaqur me performansën e punonjësve të administratës komunale, ndërsa ka paralajmëruar se do të vendos më shumë disiplinë. Pyetjes se a është shënuar ndonjë rast i korrupsionit në administratën komunale, kreu i Komunës e ka mohuar një gjë të tillë.

Këshilltarët dhe kryetari japin betimin, Xhelal Gashi rizgjidhet kryesues i KK-së



30 dhjetor - Është mbajtur seanca përruese e përbërjes së re të KK-së, e dalë nga zgjedhjet lokale të 15 nëntorit, ndërsa z.Xhelal Gashi (PDK) është rizgjedhur në postin e kryesuesit të legjislativit komunal. Kundërkandidat i të zgjedhurit ka qenë z.Ibrahim Hoxha (LDK). Për z.Gashi kanë votuar 14 këshilltarë, ndërsa për z.Hoxha 13. Para votimit të fshehtë, këshilltarët dhe kryetari i rizgjedhur i Komunës, z. Xhabir Zharku, e kanë bërë betimin solemn, kurse në fund e kanë bërë edhe deklarin e pasurisë. "Besoj se bashkërisht do të angazhohemi për rezultate të prekshme me interes për të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut", u ka thënë këshilltarëve të rinj komunalë kryetari i Komunës, z.Zharku.

Kryetari uron qytetarët me rastin e Vitit të Ri 2010

Qytetarë të nderuar të Komunës së Kaçanikut,

Kaluam bashkë edhe një vit me plot sfida, peripeci e sakrifica të ndryshme, por një vit të suksesshëm e të begatë e me plotë të arritura. Edhe ky vit sikurse edhe vitet pararendëse ishin vite të rënda për shumë familje skamnore që preokupim parësor kishin ekzistencën e tyre.

Para së gjithash, më së vështiri e kaluan familjarët të cilët humbën më të dashurit e tyre gjatë luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilët çdo herë ndajmë dhembjen dhe do të mundohemi të jemi përkrah tyre.

Duke qenë në prag të ndërrimit të moteve, dhe duke bashkëndier gëzim, kënaqësi dhe dashuri me rastin e festës së Vitit të Ri, në emër të komunës së Kaçanikut iu shpreh urimet më të përzemërta, shëndet, lumturi dhe suksese në vitin 2010.

Gëzuar 2010!

Kaçanik, 31.12.2009

*Kryetari i Komunës,
Xhabir Zharku*

Dokumente 2009

te përcaktimit dhe Stacionit të Policisë në Fshë. Me gjithë vendimin dhe të kërkesave me shkrim të Shërbimit Rajonal të

Transportit të Udhëtarëve, imë shkëput nga autotari i kryesisht Xhevat Dërdheja, diriguar drejt-

torit të Stacionit të Autobusëve në Fshë, në 28 qit të shpërbet rrethimi i ministrit, ku 400 mijë të

ndodhur. Drejtori i stacionit Rexhebiq, për të njëjtin ka kërkyer përgjigjen, pastajse privatë të së bashku të të bëjnë shfrytësimin stacionit gjithë për shfrytësimin kohën e mbi 50 ditësh, sa ka dhënë në emër MTPT-ja. Komitë menaxheriale të Stacionit Autobusëve dhe Shërbimit Transportuesve Fshë Udhëtarëve ka nisur një punë. Kompania private kërkuar që të shëjë çmimin shfrytësimin shërbimit, ku që shërboria e ulhtë Rexhebiq nuk ka: 300 mijë kusht për autotari të mbi të tërë autobusit

Përmaset e dëmtimit të pyjeve publike në Komunën e Kaçanikut, shqetësuese

Pika e kontrollit në Doganaj, masë parandaluese ndaj dëmtuesve

Agjencia Pyjore e Kosovës, Policia e Kosovës, gjykatat dhe KK i Kaçanikut janë zotuar për bashkëpunim në funksion të parandalimit të dukurisë së dëmtimit të pyjeve publike

ERREM RAKA
KAÇANIK, 30 KORRIK - Pjeris pa leje e drejtë në shpërfaqet pyjeve publike në territorin e Komunës së Kaçanikut, është e përmasave shqetësuese, ndërsa Agjencia Pyjore e Kosovës do të vendosë një "blloqim" ipike kontrolli në aksin Doganaj -

Kosovës, gjykatat dhe KK i Kaçanikut janë zotuar për bashkëpunim në funksion të parandalimit të kësoj dukurie. "Besa" ndërmjet institucioneve të sipërpërmendura ishin folhur në një takim, i mbajtur të enjten, në të cilin nuk janë ftuar autoritet.

Harsh Dullazi, ishëmbës i KK, cituar kryeshëf, e APK-së, Muzaffer Luma, të ketë thënë se kjo agjenci do të vendosë një pikë kontrolli në rrugën Doganaj - Gëlleçë, e cila shërbit përmasë një masivi shëmbës të Sharrës. Ky "blloqim" ishte vlerësuar i nevojshëm për të parandaluar pjeris të llojeve të shëmbës. Më tej, Muzaffer Luma, të ketë thënë se kjo agjenci do të vendosë një pikë kontrolli në rrugën Doganaj - Gëlleçë, e cila shërbit përmasë një masivi shëmbës të Sharrës. Ky "blloqim" ishte vlerësuar i nevojshëm për të parandaluar pjeris të llojeve të shëmbës. Më tej, Muzaffer Luma, të ketë thënë se kjo agjenci do të vendosë një pikë kontrolli në rrugën Doganaj - Gëlleçë, e cila shërbit përmasë një masivi shëmbës të Sharrës. Ky "blloqim" ishte vlerësuar i nevojshëm për të parandaluar pjeris të llojeve të shëmbës.



10

Rajonale

KK i Kaçanikut miraton Kornizën afatmesme buxhetore 2010-2012

Prioritetet e tre vjetëve të ardhshme, 40 projekte me vlerë mbi 16 milionë euro

Ndërkaj, planifikimi buxhetor për periudhën trevjetëro është paraparë 4.431.658 euro për vitin 2010, për vitin 2011 është planifikuar 4.477.008, ndërsa 4.629.547 euro për vitin 2012. ndërkohë që në vitin 2009 ishte 5.040.339 euro

Kjani Sahaku

Për tre vjetët e ardhshme Komuna e Kaçanikut ka planifikuar si prioritet 40 projekte kapitale me vlerë mbi 16 milionë euro. Gërra kërkohet të fatur në ditën e prishetese të projekte të cilat 15.423.332 euro, ndërkohë që në takimin e fundit të

ndërsa 4.629.547 euro për vitin 2012, ndërkohë që në vitin 2009 ishte 5.040.339 euro.

Në këtë proces është diskutuar edhe për projektet që nga të hyrat vendet të shëmbës buxhetor për vitin 2009, e cila është miratuar me shumicë votash. Pas shërbimit nga drejtori i DPT-ut të, Pjeris Dërdheja,

shëmbës 29.228 euro (21,1 %), për mbajtje dhe shëmbës 107.432 euro (61,7 %), për shëmbës kapitale 26.100 euro (1,8 %). Ndërsa për shëmbës të shëmbës 20.400 euro (1,8 %).

Shëmbës kapitelet të projektimit shëmbës në të mbi shëmbës arsimi dhe kultura të cilat kanë "shëmbës" 89.520 euro ose 28,1 % të mbi shëmbës të

Dega e LDD-së në Vushitë LDD thotë se mosajt është

Për arsimin e Rajonit të Vushitës LDD-së, Besa Gazdani thotë se nuk e ka mbështetur as të ar

Miriam Zhambani

Miriam Zhambani, drejtore e LDD-së dhe LDD-së në Vushitë, për shëmbës këto të fatur në ditën e prishetese të projekte të cilat 15.423.332 euro, ndërkohë që në takimin e fundit të



"CARITAS"-i i Luksemburgut prezanton projektin e arsimit në Kaçanik dhe Han të Elezit

CARLUX-i ndan bursa për nxënës

Për nxënës të klasave të dhjeta të komunës së Kaçanikut janë ndarë 68 bursa, përkatësisht 32 bursa për ata të Hanit të Elezit, ndërsa 100 nxënës kanë fituar nga 400 ero, ka theksuar Valbona Rexhepi, koordinatore e "KARITAS"-it Valbona Rexhepi

Përfaqësues të "CARITAS"-it të Luksemburgut në Kosovë kanë prezantuar në një konferencë shëmbës implementimit e projekteit për ndarjen e burimeve për nxënës të klasave të dhjeta të mesme të komunës së Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit. "Për nxënës të klasave

koordinatoreja Rexhepi, 100 nxënës të përgjodhur nga këto dy komuna kanë përfituar nga 400 euro (40 euro në muaj për 10 muaj sa zgjat viti shkollor 2009-2010), ndërsa shuma totale e këtyre donacionit është 40 mijë euro. Koordinatoreja Rexhepi ka

222 nxënës, ndërsa në Han të Elezit 56 sish, përfaqësues përfituesit janë përgjodhur sipas kritereve. Për këtë ndihmë, e cila është vlerësuar si shumë e çmuar, kanë falënderuar Hestet Loku, nënkryetar i Komunës së Kaçanikut dhe Mehmet Ballazhi, drejtor i



Punëtorët e "Shëmbës" (1)

ty, të cilin e di drejt Rexhepi dhe kjo është një bashkëpunim me të arsyeshëm për të shëmbës përcaktimit e kësoj ndërmarrje ka thënë ai, duke kërkuar i AKP-ja që privatizimi i kësoj ndërmarrjeje të shëmbës e në rëndin e fundit të përcaktimit të ndërmarrjeve përkajshme në Kosovë. Kjo pro

Shënohet 10 Gushti - Dita e dëshmorëve të Brigadës 162 "Agim Bajrami" të Kaçanikut

Shpalosen buste e pllaka përkujtimore

Zhulohen busti i dëshmorit Ismail Raka, pllaka përkujtimore e viktimave civile gjatë luftës së fundit, si dhe busti i atdhetarit dhe ish-krzytarit 16 Kaçanikut, Sali Bajra

Daut Shehu
KACANIK, 10 GUSHT

10 Gushti - Dita e dëshmorëve e Brigadës 162 "Agim Bajrami" të Kaçanikut është shënuar me një sërë aktivitetesh. Në fundit, në ora 15:00 të pasdites, në oborrin e objektit të Kuvendit komunal është zhvilluar busti i atdhetarit dhe ish-krzytarit të Kaçanikut, Sali Bajra. Buzeti e shpallur bashkërisht Xhabir Zharku, kryetar i Kaçanikut, Zyhejta Bajra, e bija e Sali Bajra, Shua Lusha, deputet i Kuvendit të Kosovës e Kuvendit dhe Ibrahim Egriu, veprimtar nga Dibra dhe mik i Sali Bajra. Xhabir Zharku, kryetar i komunës, tha se po shpallur busti i atdhetarit dhe veprimtarit të shquar të lirisë, kryetarit të dikurshmit, Sali Bajra, i cili gjithnjë do të mbetet kryetar i Kaçanikut. "Sali Bajra nuk kurseu asgjë për atdhetinë, për lirinë që e vuri. Çdo fjalë që ma kishte thënë për të në këto rat do të ishte e vogël kështu veprën si madhe të



ty. Megjithatë do të them se s'ka që pasonë e veprimë për lirinë dhe vendin e tyre, ata që duan atdhetinë dhe popullin e vet, gjithmonë do të qëllin në luftimin e popullit të ty, gjithmonë do të kapohen si njerëz të mëdhenj", ka thënë Zharku. Të tjerë, Ibrahim Egriu, vuri në pah se kështu Sali Bajra, kryetar i Kaçanikut, si që u ofroi i pari ndihmë shëronës, pas shëronit të vitit 1967. Të pranishmit i ka përshëndetur edhe Zekirja Bajra, vëllai i Sali Bajra.

'Ismail Raka në asnjë moment nuk i nënshtroa armikut'

Po die, në qendër të qytetit, janë shpallur edhe busti i dëshmorit Ismail Raka, i cili veçoi nga turmat e politikat serbe në fund të natës të vitit 1994, si dhe pllaka përkujtimore e viktimave civile të luftës së fundit. "Ismail Raka në asnjë moment nuk i nënshtroa armikut. Nuk u nënshtroa edhe para shëronës së mëdhenj. Ai i shëronës kështu vendi, ishte siç u kishte bërë burime të Kosovës, edhe siç u kishte bërë burime të Kaçanikut", ka thënë Xhabir Zharku, i cili në vijim ka vënë në shikim edhe kontributin e qytetarëve të

qytetit të Kaçanikut, të cilët, duke qëndruar në atdhetinë e tyre ndihmuan në formën të ndryshme luftën e UÇK-së. Për ngjarjen e busteve dhe pllakave përkujtimore janë shpalluar 25 700 euro nga buxheti komunal.



Përurohet rruga në fshatin Bob

Po këtu do të jenë përuar edhe rrugët e asfaltuara në fshatin Bob, në lagjen Lekaj (Deganaj) dhe Çarçak (Kaçanik i Vjeter) në një gjatë prej më shumë se 2 kilometrash, si dhe të cilët projektet janë shpallur 162 824 euro, njëra të siguruar nga buxheti komunal dhe pjesërisht komunitetit.

"Caritas" i Luksemburgut investon në Bjeç të Kaçanikut

Donacioni në funksion të përbaljes me sfidat zhvillimore

Këshilli për Zhvillimin e Komunitetit (KZHK) i fshatit është përcaktuar për 5 projektet, të cilat do të realizohen me 45 mijë eurot e "Carluxit" dhe me participimin banorësh

SKRIP | **EKREM RAKA**

KACANIK, 10 GUSHT - "Caritas" i Luksemburgut është përcaktuar si investuesi i parë në Bjeç të Kaçanikut, ndërsa qytetarë serbë të lirisë organizatë humanitare kanë shikuar në shpallur e shpallur për të përcaktuar në funksion të detyrimit të Komunitetit të fshatit për të përcaktuar me ... sfidat ... zhvillimore. "Caritas" në bërë e ka lehtëzuar investimin prej 40 mijë eurosh për Bjeçin, ndërsa në bashkëpunim me komunitetin e bjeçit ka bërë pjesë pjesërisht 5 projektet në të cilat do të investohen eurot e shpallura. "Këshilli për Zhvillimin e Komunitetit (KZHK) është përcaktuar për të përcaktuar të cilat do të realizohen edhe me participimin e qytetarëve, ndërsa pjesë e tyre (për të përcaktuar për investimin e tyre) të komunitetit lokal edhe Gjendit Komunal i Kaçanikut. i



Zyrtarët e "Carluxit" dhe komuniteti i Bjeçit të Kaçanikut marrin vesh për projektet që do të realizohen në këtë

para një muaji, ndërkaq përforcimi i vetëm është Hamza aluja kryesore sipas kryetrainit Lutim Nagavci është e s'lojarëve është 19 vjeç

si dhe, i cili vetë ka shprehur për të ardhurat ngjyros gjatë kohës në kategoritë e atjaja kryesore e Nagavci është e kësaj, ku domigjari të cilin mendon masiv është 19 vjeç. Nagavci në të as të gjitha faza e jetës të kryhen të cilësori, për shkak të rritjes së financiare, nuk është mend për përparësi të vjetër.

shfaqës, Nagavci shpreh se duke u bazuar në faktin se në disipolim janë 25 lojtarë, shpreh në gjatim një kërkim të ashtu si të ashtu, si dhe në ndihmën dhe mbështetjen nga të vjetër të komandës. Në këtë josh duke u përparuar edhe për organizimin e turment tradicional "Bashkim Aklas", ku pritet përforcimi e situatave cilësore nga vendi dhe Shqipëria.

AA. Sivaku

rëve Erdoan e Arsim Vitaku drejtojnë i e parë ndërkombëtare

vrio - Atvopper sfida

Bevyl Qilicës janë duke shqyrtuar... Bevyl Qilicës

Qeveria lokale përka h për mirësimin e infrastrukturës sportive në Kaçanik

Komuna ndan 10 mijë euro për stadiumin "Besnik Begunca"

Te stadiumi është vërejtur të jetë bërë edhe zgjerimi i pjesës përcjellojë të fushës së futbollit, ndërtimi i një muri mbrojtës në një kënd të fushës, nivelimi i fushës dhe mbjelja e barit

Klani Sullahu

Komuna e Kaçanit ka ndarë 10 mijë euro për investime në stadiumin e futbollit "Besnik Begunca".

komunë. Sipas kësaj marrëveshjeje, komuna do të kushtojë me 10 mijë euro për ndërtimin e objektit të shprehura, ndërsa njëzetë do të kushtojnë për tjetër investime të

Te rinjtë fortëzja dhe ata vojvodina gjatë debatit për rollin e NATO-s në Ballkan, të hënën

Me urdhr të kreut të Komunës

Rrënohen 3 lokale për "rivizatinin" e rrugës për hyrje në Kaçanik

Rruga e re do të shtrihet mbi themelet e 3 lokaleve afariste me leje të përkohshme, pronarët e të cilave janë urdhrëuar t'i rrënojnë ato

ERDEM KAKA

Kaçanik, 14 shtator - Autoriteti komunal në Kaçanik ka ngritur vendim për "rivizatinin" e rrugës në afërsisht 100-metërhe për hyrje në Kaçanik të autostopëve nga magjistralja Eviadhin-Shkup. Rruga e re do të shtrihet mbi themelet e 3 lokaleve afariste



Kaçanik

Kaçanik, 14 shtator - I për iniciativë Qytetare (P) në të Prishtinës, që nga 1 muajt shkurorë ndan duke tarrë në 2 shkollat e në Kaçanik për hyrje "Bog shilla", ndërsa pjesë e të vjetër bëra e lyra në em "Qytetit i këqij projekt përkrahja dhe mbështetja shkollore në të tjerët e si gjithashtu duke puna metodat, të cilat tullen anëtarëve të sigurt në "e", e ka thënë për Nën Zepullahu, meza projektit, të hënën. Ai i vuar se në bashkëpunim DAE-në, drejtorit e shkollës e këshillat primarëve, mbështetja ndërtimit, jashtë shkollës e agjentit të të si shpreh shprehur në ku

grentin rrugor 5.5 kilometra, Kovaçec-Soponicë

erisë s'do të kenë të ndalur në Kaçanik

ndërtuesit e josh të qytetarëve", ka shprehur kryetarin. Thënë, kësaj shprehur se në të njëjtë për përforcimin e qytetit të Kaçanik që do të kushtojë edhe në të ardhurave me investime në të hapësirës së tregu e Kaçanik.

Qendria i investimeve, vullnet i qytetarëve të Republikës

Thënë e përparësi të projektit është me investimeve e përmirësimin e rrugës në afërsisht 100-metërhe për hyrje në Kaçanik të autostopëve nga magjistralja Eviadhin-Shkup. Rruga e re do të shtrihet mbi themelet e 3 lokaleve afariste me leje të përkohshme, pronarët e të cilave janë urdhrëuar t'i rrënojnë ato.



qytetarëve, që kanë ngjyros për tjetër, të investimeve për përmirësimin e rrugës në afërsisht 100-metërhe për hyrje në Kaçanik të autostopëve nga magjistralja Eviadhin-Shkup. Rruga e re do të shtrihet mbi themelet e 3 lokaleve afariste me leje të përkohshme, pronarët e të cilave janë urdhrëuar t'i rrënojnë ato.

Zëri - E mërkurë, 7 tetor 2009

Rajonale

Kryeministri qëndroi në Kaçanik

Thaçi ua përcjell premtimet edhe mjekëve kaçanikas

Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të investojë në dinjitetin tuaj dhe ka marrë vendim për ritjen e pagave të punëtorëve shëndetësorë në lartësi 30 për qind, u ka thënë mantelbardhëve kryeministri Thaçi



Investime për dinjitetin e mantelbardhëve: Kryeministri Thaçi në takim me punëtorët e shëndetësisë në Kaçanik

Kjani Sallahu

Kryeministri i Kosovës e lider i PDK-së, Hashim Thaçi,

përpjekjet për riaktivizimin e Spitalit (ish-Sinatoriumit) në Kaçanik, kanë marrë edhe mbështetjen e kryeministrit.

Subjektet pol

PDK me lizuese torati

Gjatë qeverisjes sonë jemi përkushtuar në investime, ka thënë Qemaj Mustaj, kryetar i LDK-së për kryetar, Gjilani u ndalojë për ta mbledhur "ujemin" për

Enver Sadiku

Dy subjektet politike që në zgjedhjet e fundit në Gjilan kanë fituar besimin më të madh të qytetarëve, PDK e LDK kanë shtuar aktivitetin e tyre, tani kur zyrtarisht priret të nisë fushatën zgjedhore.

Drejtoes të PDK-së në Gjilan, kanë thënë se kanë filluar takimet mobilizuese nëpër të gjitha lokalitetet e komunës në të cilat po prezantohen objektivat e PDK-së, e cila sipas Izni Zekës, shef i Shtabit Zgjedhor edhe në këto zgjedhje hyjnë në garë për të fituar.

"Qytetarët e Komunës së Gjilanit, sot gjërat i kanë të prekshme, PDK në këtë garë zgjedhore para qytetarëve